



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 14.10. 2011

T R A N S K R I P T

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
14.10. 2011. GODINE

TETOR – OKTOMBAR
2011

E premte, më 14.10.2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Mirë se keni ardhur!

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupeve parlamentare zgjatin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Nëse flasin në emër të grupit, thotë në emër të grupit edhe ata kanë përparësi ta marrin fjalën, nëse në emër të vet personal, presin pak më vonë.

A jeni dakord!

Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ndihem i obliguar për hir të opinionit të bëj një sqarim këtu në Kuvendin e Kosovës rreth një konfuzioni që e kanë ngritur kolegët e caktuar deputetë nga radhët e “Vetëvendosjes”

Ndonëse disa prej tyre i kam miq të mirë nga e kaluara, megjithatë më duhet të them se nuk është e qëlluar metoda e spekulimit si mënyrë e tyre e përfitimit politik, aq më shumë kur kjo sajohet në një mënyrë aq qesharake sikurse ndodhi në një konferencë shtypi të këtyre ditëve të këtij grupimi politik që u transferua nga lëvizje në parti politike në zgjedhjet e fundit në Kosovë.

Personalisht nuk merren me transfere politike. Gjithashtu nuk do të doja që deputetët e Kuvendit të Kosovës të cilët do tabor politik qofshin të jenë të tranferueshëm politikisht.

Mendoj secili këtu përfaqëson diçka, përfaqëson votën e një komuniteti apo të njerëzve të caktuar dhe jam i vetëdijshëm plotësisht për këtë.

Ishte shumë qesharake konferenca për shtyp e “Vetëvendosjes” në të cilën një deputet i saj parafratoi emrin tim si ofertues kinse për ta blerë një deputet të saj.

Mendoj se ekzagjerimi i tillë i një momenti krejt qesharak nga lëvizja “Vetëvendosje” tregon shkallën e paranojës në të cilën ka rrëshqitur ky subjekt, pas zhvillimeve të fundit

brenda atij. Nëse ata kanë telashe të brendshme, as unë e askush prej nesh nuk ka faj për këtë. Ne nuk jemi fajtor nëse deputetët e “Vetëvendosjes” apo të grupimit të saj ka nisur të braktisin atë.

Gjithashtu dua të them qartë se askujt s’i kam ofruar të ndërrojë tabor politik, nuk është kjo mënyra ime e punës, as me aleatë e as me kundërshtarë politikë. Unë veproj hapur, veproj në sy të gjithëve dhe para opinionit, nuk veproj skutave dhe keqpërdor emrin e askujt. “Vetëvendosje” keqpërdori emrin tim në një kontekst që s’do t’u kishte hije atyre. Tek e fundit nëse synojmë “të blejmë” ndonjë deputetë, ne sigurisht se do të synonim ndryshe dhe diku ku me të vërtet ka vlera.

Më lejoni të nderuar kolegë të them se në politikë mbijetojnë vetëm vlera e vërteta, në politikë nuk mbijetojnë ata që sot shfaqen e nesër zhduken vetvetiu si bryma para diellit.

Të tillë sigurisht se nuk janë target i imi as i subjektit që i takoj. Unë dhe subjekti politik ku jam i rreshtuar synojmë vetëm vlerat e vërteta politike e ato janë të mjaftueshme në radhët tona. Ata u kanë mbijetuar shumë e shumë sfidave dhe nuk janë marrë me cikërrima për të bërë diçka nga kurrëkafja.

Seanca, skena e “Vetëvendosjes” atë ditë ma kujton të kundërtën, fatkeqësisht është e dhembshurishme. Dhe dua të citoj edhe një alegori tjetër në fjalimin tim për ata që po duhen të shpërfaqen “më katolik se Papa.”

Ua sugjeroj të nderuar kolegë të “Vetëvendosjes” të lexoni me vëmendje romanin “Ferma e Kafshëve” të shkrimtarit Georg Wuerel. Aty është e shpërfaqur më së miri mundësia dhe rreziku i secilit prej nesh.

Derrat e udhëheqin një revolucion kundër patronëve në fermë, kundër njeriut, për ta ndryshuar jetën dhe në fund pikërisht ata bëhen si njeriu shkelës dhe shtypës, adaptohen me një jetë tjetër me këmisha, rroba, kade, profite e rahatllëk. Kam frikë se edhe “Vetëvendosja” po rrëshqet në këtë alegori të “Fermës së Kafshëve” dhe Georg Wuerelit, këta thirren si të lexueshëm dhe ma merr mendja e kanë shfletuar librin.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo qasje nuk qon askund, ata që nuk kanë ndonjë vlerë tjetër sigurisht se përditë do të mundohen ta ndërtojnë rrejtshëm atë mbi spekulimet, rrenën dhe të pavërtetën. Në rastin konkret në të cilën unë po reagoj, kolegët e “Vetëvendosjes” bënë një gjë të tillë, thanë që unë e paskam ftuar ndonjërin prej tyre t’i bashkohet grupimit tonë parlamentar, rrejtën!

Ne jemi në një kohë kur po synojmë të arritura të tjera më të mëdha se sa të përfitojmë ndonjë deputetë që ka këtë mandat e nesër kthehet aty ku ishte. “Katundi që shihet kallauz nuk do”, Marks, Lenini, Stalini e tash Fidel Kastro e Hugo Çavez kanë perënduar. Ata të gjallë janë vetëm në kokat e disa deputetëve shterp që po duhet ta ndrisin çmimin e tyre me spekulime...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

5 minuta i ka në emër të grupit.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para dy ditëve Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit.

Dje dhe pardje përfaqësuesit e Qeverisë dhe kryeministri, gjatë gjithë kohës janë munduar të na bindin secilin qytetar të Kosovës se raporti është pozitiv. Por edhe për kryeministrin dhe për përfaqësuesit e tij kjo nuk është problem, sepse kjo Qeveri nuk e ka herën e parë që të zezës i thotë e bardhë.

Raporti është negativ dhe kushdo që mundohet ta interpretoj ndryshe ta dimë se nuk po e thotë të vërtetën. Vetë gjuha e raportit nuk lenë shumë për dëshiruar. Fjalës progres i janë dhënë epitete nga më të ndryshmet me të cilat Qeveria mundohet të na bind se me të vërtet ka bërë ndonjë progres.

Në raport flitet për progres të limituar, progres të kufizuar, pak progres, progres të përzier, që lë të nënkuptosh që në disa fusha janë bërë tre hapa para e pesë mbrapa.

Një shembull i tillë është kur Qeveria bie në Kuvend ligje normalisht se për shkak të numrave të shumicës së thjeshtë ato kalojnë, mirëpo janë ligje të cilat nuk kanë mbështetje financiare dhe nuk implementohen në 5 – 6 vitet e ardhshme, ky është progres i përzier. Domethënë, kemi ligje, kemi dokumente, mirëpo në kualitetin e jetës së qytetarit nuk ka ndërruar asgjë.

Raporti i Progresit është konsideruar nga kryeministri si raporti më i mirë që ka marrë ndonjëherë Kosova dhe kur kryeministri dhe përfaqësuesit e tjerë të Qeverisë gjenden para kritikave konkrete të Raportit, kur ne citojmë raportin ata justifikohen se ne jemi një shtet i ri

Edhe sa vite ne si shtet i ri duhet ta lëmë korrupsionin të lulëzojë, krimin e organizuar të rritet, papunësinë të numërojmë në vend, buxhetin dhe pushtetin të keqpërdoren, politikën të ndërhyjë në çdo sferë të jetës, nepotizmin, kufizimin e lirisë së të shprehurit dhe veriun e pa integruar.

Deri kur Qeveria do ta kontrolloj Kuvendin, deri kur kemi vendime ad-hoc, deri kur Kosova do t'i shpenzojë paratë të cilat nuk i ka, deri kur do të fshihemi pas perdes se jemi një shtet i ri?

Të nderuar, historia po përsëritet, sepse ne kemi Qeverinë më optimiste që një vend mund ta ketë. Nëse rritja e krimit të organizuar quhet progres, atëherë çka nëse rritja e trafikimit të qenieve njerëzore dhe drogës quhet progres, atëherë çka, nëse korrupsioni nuk qenka korrupsion si mund ta luftojmë, nëse ministrat punësojnë gjithë farefisën e dikasteret e tyre dhe ky nuk quhet nepotizëm, atëherë kjo nuk shihet si problem, nëse mos planifikimi qenka plan, atëherë pse Qeveria të ketë një plan dhe strategji për zhvillim, nëse arka e shtetit bie në zero dhe ky nuk quhet falimentim, atëherë pse të brengosemi? Kështu Qeveria jonë e sheh Raportin e Progresit, nëse të gjitha këto dukuri shihen kështu atëherë ku ka të bëjë ndryshime? Me një qeverisje të tillë, raporte të tilla do të kemi edhe për 30 vjetët e ardhshme. Mirëpo, BE-ja asnjëherë nuk do t'i hapë dyert për Kosovën.

Të nderuar, edhe një gjë, tendenca e kësaj Qeverie është që të gjithë këtë negativizëm që shprehet në Raportin e Progresit, të gjitha këto vërejtje t'i mbulojë me rekomandimin që është dhënë në strategjinë për zgjerim për të filluar dialogun për liberalizimin e vizave. Ky është vetëm një rekomandim, nuk është premtuar, nuk është dhënë udhërrëfyesi do të fillojë dialogu, edhe kjo nuk është ku ta di sa një gjë e madhe, sepse ne kemi 45% të popullsisë të papunësuar, ku do të shkojnë këta të shkretë, këta nuk mund t'i ngopin familjet e tyre me bukë? Kjo është një lajm i mirë për njerëz të cilët po marrin paratë e shtetit dhe po keqpërdorin pozitat e tyre zyrtare, sepse janë ata të cilët shkojnë 2 deri 5 herë në vit në pushime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj, deputetë, që kjo pikë e rendit të ditës është për çështje që nuk mund të ngriten në rend të ditës dhe që janë në interes të publikut. Çështjet që mund të ngriten në rend të ditës dhe për debat më substancial se sa për 3 – 4 minuta, unë mendoj që duhet të ngriten. Grupet parlamentare duhet të bëjnë kërkesë dhe t'i ngritin këto çështje për debat dhe ta shfrytëzojnë këtë pikë të rendit të ditës për çështje që janë në interes të publikut. Edhe pse edhe kjo është në interes të publikut. Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës, Lagja e Boshnjakëve në Mitrovicë është pikë kyçe për zhvillimin e ngjarjeve në veri të Kosovës. Ajo zë një hapësirë mjaft të madhe për nga sipërfaqja, mbi 1/3 e 2.5 km², sa përbën pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës.

Veriu i Mitrovicës i ka rreth 15.000 banorë, numri më i madh i banorëve janë serbë për shkak se përgjatë 13 vjetëve atje ka ndodhur pastrimi etnik i shqiptarëve. Ky pastrim etnik ndonjëherë ka qenë vazhdim i luftës, sikurse ka ndodhur në natën ndërmjet 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000, kur u patën vrarë 11 shqiptarë (6 burra e 5 gra), ndërkaq gjatë atij muaji ishin dëbuar 1.564 familje shqiptare me gjithsej 11.364 anëtarë, kurse herrave të tjera, ai është zbatuar përmes blerjes së shtëpive të shqiptarëve nga Qeveria e Serbisë dhe ndërtimit të banesave kolektive për serbët atje.

Përveç shqiptarëve dhe serbëve, në këtë lagje banojnë një pjesë e konsiderueshme e boshnjakëve dhe ashkalive, qëndrimi i të cilëve përgjithësisht është për pavarësinë e Kosovës dhe për institucionet e Kosovës, si dhe i romëve të cilët duke qenë të vendosur

në kompleksin e Auto- Remontit, anojnë më shumë kah strukturat ilegale të Serbisë, që po ashtu janë të vendosura aty dhe numri i të cilëve rritet shumë në momentet e krizave.

Pas 25 korrikut, sikurse edhe në rrugët tjera që lidhin veriun me pjesën tjetër të Kosovës, edhe në Lagjen e Boshnjakëve, te udhëkryqi i tretë i rrugës kryesore, strukturat ilegale dhe armiqësore të Serbisë vendosën barrikadë dhe e ndanë lagjen në dysh.

Në këtë lagje qytetarët jetojnë në ankth për shkak të sulmeve të kohëpaskohshme, sikurse që ishte ai i serbëve të maskuar në tri vetura në breg të lumit Sitnica, të cilët me 28 shtator rrahën punëtorët shqiptarë dhe boshnjakë që po e pastronin lumin në kuadër të një projekti të USAID-it.

Po ashtu, më 10 tetor, serbët që e ruajnë barrikadën në urën kryesore sulmuan një banorë shqiptarë të Lagjes së Boshnjakëve, Bukurie Krasniqin, e cila po kalonte urën nga pjesa veriore në pjesën jugore.

Para bllokimit të urës kryesore, nxënësit e Lagjes së Boshnjakëve, të cilët vijnë në mësimin në shkollën “Muharrem Bekteshi” e cila gjendet në pjesën jugore pranë urës dhe sallës së sporteve, kanë kaluar nëpër urën kryesore meqenëse kjo është rruga më e shkurtër për ta. Pas bllokadës ata janë të detyruar të shfrytëzojnë urën e Lagjes së Boshnjakëve, gjë që ua ka rritur shumë distancën që ata duhet ta përshkojnë për të mbërritur në shkollë.

Shumë serbë që jetojnë në Lagjen e Boshnjakëve janë pjesëtarë të MUP-it famëkeq dhe ky fakt është publik. Të tjerët të cilët nuk janë të angazhuar në MUP, janë përfshirë në kuadër të sigurimit të quajtur SOKO apo edhe si zjarrfikës. Sigurimi SOKO bën roje në pothuajse të gjitha objektet e strukturave ilegale të Serbisë.

Nga rreth 80 policë që shërbejnë në stacionin policor të veriut, vetëm 7 janë shqiptarë. Institucionet e Kosovës kanë vetëm një Zyrë për Shërbime Civile, për sigurinë e së cilës angazhohen zakonisht 3 ose 4 policë, që kur ka trazira kërkojnë mbështetjen e banorëve të lagjes për sigurinë e tyre, ashtu siç ka ndodhur për shembull më 2 korrik të vitit 2010, kur u vra mjeku boshnjak, Mesud Xheković.

Dhe tash, një vit më vonë, 27 shqiptarë janë marrë në pyetje prej EULEX-it, nuk e dinë a si dëshmitarë, a si të dyshimtë, në kohën kur në fakt krimet janë shumë aktuale prej strukturave të Serbisë atje.

Përkundrazi, Serbia në Lagjen e Boshnjakëve, për dallim prej neve ka Kuvendin Komunal të vendosur në disa objekte, pastaj të ashtuquajturën Ministrinë për Kosovë dhe Metohi, ku ka zyrën edhe Oliver Ivanović, që këto institucione kanë investuar 9 vjet në te, Mbrojtjen Popullore, Odën Ekonomike Serbe për Kosovë, zjarrfikësit, kuzhinën popullore, barnatoren shtetërore serbe, Auto- Remontin etj.

Sipas disa regjistrimeve, në Lagjen e Boshnjakëve jetojnë rreth 830 shqiptarë, 150 boshnjakë, 50 turq, 20 ashkali dhe një numër i panjohur për neve i serbëve. Mirëpo, kjo

lagje nuk ka as shkollë, as çerdhe, as ambulancë apo barnatore, as bankë apo postë, si dhe s'ka qasje në televizione kabllorike. Po ashtu, as telefonja fikse nuk funksionon, pasi që sipas arsyetimit të zyrtarëve të PTK-së, ka prishje në rrjetin nëntokësor afër kafenesë "Dolce vita" dhe askush nga teknikët shqiptarë nuk guxon të afrohet atje për ta riparuar prishjen.

Mbrëmë, me 13 tetor 2011, në urën që lidh këtë lagje me jugun e Mitrovicës, pjesëtarë të KFOR-it kanë vendosur gjashtë dengje të telave me gjemba me të cilët në rast trazirash do ta bllokonin urën. Kjo do të thotë se në rast të trazirave, në Lagjen e Boshnjakëve, KFOR-i bllokoi urën, me ç'rast pamundësohet kalimi i shqiptarëve nga jugu për në Lagjen e Boshnjakëve dhe asisoj banorët e kësaj lagjeje do të lireshin në mëshirën e strukturave ilegale dhe të bandave serbe.

Shumë banorë shqiptarë të kësaj lagjeje kanë kërkesa për ndërtimin e më shumë se një banese kolektive për banorët shqiptarë, të cilat do të mund të ndërtoheshin përmes partneritetit të ndërtuesve, pronarëve të trojeve dhe komunës. Problem është se komuna në veri që vepron nën UNMIK-un nuk jep leje për shqiptarët, por vetëm për serbët. Ata nuk i pranojnë lejet nga komuna jonë në jug.

Prej 25 korrikut, komuna u ka dërguar ndihma vetëm një herë (një pako me miell, 2 litra vaj, shpageta dhe shampun) me vlerë prej 24 euro. Përveç kësaj, komuna paguan udhëtimin e studentëve nga kjo lagje për në Prishtinë, si dhe ushqimin e tyre në Mensën e Studentëve në Prishtinë.

Së fundmi, komuna ka filluar rindërtimin e katër shtëpive, pronë të shqiptarëve, të djegur gjatë luftës. Po ashtu, një familjeje me një pjesëtar me nevojë të posaçme i ka ndarë një fond prej 400 eurove për renovimin e njëjës sanitare të përshtatshme. Kjo pra është pak, shumë pak!

Lagjja e Boshnjakëve i ka vetëm tre banorë që janë të punësuar në polici, dy boshnjakë dhe një shqiptarë. Gjithashtu, nga Lagja e Boshnjakëve vetëm tre prej tyre janë pjesëtarë në FSK. Sipas banorëve...

Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Këtu nuk vazhdohet Albin, po megjithatë po e bëjmë një përjashtim, 30 sekonda, vazhdo!

ALBIN KURTI: Sipas banorëve të lagjes, Bajram Rexhepi nuk ka qenë në Lagjen e Boshnjakëve që prej 12 shkurtit të vitit 2008.

Problem për sigurinë në këtë lagje është edhe qarkullimi i veturave pa kurrfarë targash pasi që në mungesë të tyre identifikimi i shkaktarëve të sulmeve është i pamundur. Shqiptarët në Lagjen e Boshnjakëve janë në Lagjen e Boshnjakëve, sepse janë bashkë. Në Lagjen e Boshnjakëve po mbrohet shteti i Kosovës, i cili nuk po e mbron lagjen e Boshnjakëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës, deputeti Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën. Në emër të Grupit më duket, thashë edhe unë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mënyra se si ne e kemi kuptuar këtë pikë të rendit të ditës është që mund të flasim për tema të cilat nuk janë në rend të ditës, e jo tema të cilat nuk mund të hyjnë në rend të ditës se, fundi i fundit, s'besoj që ka temë që nuk mund të hyjë në rend të ditës në Kosovës.

Sidoqoftë, po kthehem menjëherë në temë.

Faleminderit, kryetar!

Është bërë goxha bajate çështja se a është Raporti i Progresi pozitiv a negativ? Ka disa vite që bisedojmë se a është pozitiv a është negativ? Ma merr mendja që është mirë për t'i parë gjetjet e raportit edhe të pyesim se a janë të vërteta apo jo, e thashë, të vërteta. Dy ditë që kaluan, i kemi dëgjuar disa zyrtarë të lartë të qeverisë, më të lartë të Qeverisë, ministra, që kanë thënë - raporti është real. E fjalën "real" ne e kuptojmë "e vërtetë", edhe në gjuhën angleze real domethënë e vërtetë, që qëndron bile, bile pak më shumë se e vërtetë, bile e vërtetë e saktë që nuk anon as ta minimizojë, as ta maksimizojë problemin, po real, i vërtetë. E thashë, duhet të pyesim ne, jo a është pozitiv a negativ, por vetëm duhet pyetur a është e vërtetë që në veri nuk ka progres, në integrim të veriut se raporti thotë. A është e vërtetë dhe a është reale kjo punë? Duhet pyetur - a është e vërtetë që aksioni i Kosovës në veri është quajtur unilateral prej Komisionit Evropian, se shkruan? Kryeministri ka thënë, zoti kryetar, që është dakorduar edhe ka shkruar bile-bile aq më larg, që të thotë, ka qenë unison me Uashingtonin dhe me Brukselin.

A është e vërtetë që zgjedhjet e fundit janë manipuluar dhe Qeveria ka dalë prej zgjedhjeve të manipuluar? Prapë raporti thotë, a është real a jo raporti? A është e vërtetë që në Qeverinë e Kosovës ka nepotizëm? Është e vërtetë, domethënë prapë Qeveria vetë po thotë. A është e vërtetë që Qeveria nuk punon në integrim evropian për shkak se grupet punuese nuk takohet, edhe kjo shkruan në raport? A është e vërtetë që nuk ka progres në reformën e administratës? A është e vërtetë që ka ndërhyrje politike në administratë? A është e vërtetë që transportuesi publik ndikohet politikisht dhe nuk ka pavarësi editoriale prej Qeverisë? A është e vërtetë edhe kjo? A është e vërtetë se nuk ka progres sa i përket lirisë së shprehjes, le që s'ka liri të shprehjes, po as nuk është përmirësuar prej vitit të kaluar deri në sivjet? A është edhe kjo e vërtetë, a është reale qysh kanë thënë vetë këta, që raporti është real. A është e vërtetë që Qeveria nuk ka vullnet politik për ta luftuar korrupsionin edhe kjo shkruan në raport, në këtë raportin real që vetë Qeveria ka thënë që është real? I vërtetë, domethënë. A është e vërtetë që gjendja ekonomike e Kosovës nuk është përmirësuar hiq prej vitit të kaluar, bile- bile është degraduar, kështu shkruan në raport? A është reale edhe kjo pikë? A është e vërtetë, qysh kanë thënë, këta vetë kanë thënë? E vërtetë është. A është e vërtetë që GDP-ja në Kosovë është rritur për 0.1% brenda një viti kalendarik, e ne rritjen ekonomike kryeministri po na thotë e kemi 6 – 7 se di sa, kiamet shumë? A është e vërtetë edhe kjo, çka po thotë Komisioni Evropian në gjetjet e tij? A është e vërtetë që deficitin është rritur

në Kosovë, qysh po thotë Komisioni Evropian? Është e vërtetë që është rritur deficit, po harxhojmë më shumë se sa që po mund të mbledhim, shumë më shumë, domethënë, kiamet më shumë? A është e vërtetë që vit në vit në prill të këtij viti inflacioni ka mbërrirë 10.8%? A është e vërtetë edhe kjo çka po thotë Komisioni Evropian, sipas Qeverisë? A është e vërtetë se nuk ka progres në sektorin e energjisë, ka qenë premtimi kryesor i kryeministrit Thaçi edhe në zgjedhjet e para, edhe në zgjedhjet e dyta? Komisioni Evropian tash po thotë s'ka progres hiq, ka stagnim. A është edhe kjo e vërtetë? Unë po lexoj çka po shkruan në raport, nuk po dua të shpik asgjë tjetër. A është e vërtetë që ka ndërhyrje politike në emëtime në polici edhe në punën e policisë kur ka të bëjë në operacione delikate? A është e vërtetë? Komisioni Evropian në Raportin e Progresit për Kosovën po thotë kështu, edhe Qeveria ka thënë që raporti është real, as nuk po i themi negativ, as pozitiv, veç real. A është e vërtetë që Policia e Kosovës nuk po aftësohet, se nuk po ka as mjete, as vullnet politik për t'u aftësuar, a është e vërtetë, kështu po thotë Raporti i Progresit, kush e lexon?

Edhe në fund, po iu them edhe diçka tjetër, real, krejt real, krejt e vërtetë çka shkruan në raport, edhe le të thonë tash sa të munden, le të qohen e të thonë - jo nuk është real raporti, dje kanë thënë është, sot le të thonë nuk është. Unë nuk ju thashë as që është i mirë, as i keq, veç ju lexova çka shkruan edhe ju konfirmova që Qeveria e Kosovës po thotë që është e vërtetë çka po thotë në raport. Krejt çka kanë premtuar, krejt çka thonë deri sot, nuk është e vërtetë, në bazë të Raportit të Progresit. Tash, ja është Raporti i Progresit real, ja janë këta real, të dytë s'mund të jenë, se janë krejt ndryshe, totalisht kontra të vërtetës që është në Kosovë. Kosova, bashkë me këtë raport të progresit dhe me këtë Qeveri që e ka në paketë, e ka marrë edhe një premtim që ndoshta në dhjetor nis dialogu për liberalizim të vizave, ndoshta, nuk thotë nis, po mund të nisë. Çka do të thotë kjo, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës?

Zoti kryetar,

Kjo domethënë që Qeverisë ia ka vënë një gramç në shpinë edhe një herë edhe e kanë qarë pezull ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Ardian, unë nuk thashë që të mos debatohet as diskutohet kjo çështje, por unë jam i bindur që 80% e deputetëve s'e kanë lexuar raportin. Nuk është ofendim, por raporti nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe s'e keni kuptuar disa. Megjithatë, unë jam të diskutohet, por të diskutohet në një pikë që do të duhej të organizohej dhe jo kështu.

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra dhe ministra,

Unë, para disa ditësh, shumicës prej jush dhe shefave të grupeve parlamentare, nëpërmes shërbimit të Kuvendit ua kam përcjell një publikim të paradokohshëm të një historiani suedez, Joran Wasenius, i cili mban titullin "Sëmundja mistike", e cila trajton çështjen e ngjarjeve të pandriçuara deri në fund, por më shumë ngjarje që janë konsideruar si helmime masive të nxënësve dhe të rinjve të Kosovës, në pranverën e vitit 1990.

Gjatë vizitës së tij të fundit Wasenius kërkoi një takim dhe prezantoi librin dhe brengën e tij të madhe lidhur me patologjinë e rreth 8000 të rinjve kosovarë, patologji kjo e cila u shfaq brenda 10 muajsh të vitit 1990 dhe e cila ka mbetur e pasqaruar deri në fund dhe fajtorët eventual të kësaj drame kanë mbetur të paidentifikuar dhe të padënuar.

Duke e admiruar punën e zotit Wasenius, unë i premtova se këtë libër do ta përcjell te kolegët e mi deputetë dhe tek Qeveria e Kosovës dhe në bashkëpunim me ta do të shohim se çfarë mund të bëhet. Edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, Wasenius në fund të librit të tij konsideron me të drejtë se ekzistojnë perde mjegullash të cilat mund të shpërndahen lidhur me këtë ngjarje, por kjo shpërndarje e mjegullave nuk mund të bëhet jashtë Kosovës, por është detyrë e Kosovës. Edhe vetë ky historian thotë se kjo është detyrë për kosovarët

Në ndërkohë, edhe doktor Besnik Bardhi, një aktivist i dalluar dhe një njeri me kredibilitet dhe dinjitet, publikoi librin "Agoni dhe Shpresa" që përmban një mozaik dëshmish, dokumentesh e përjetimesh të autorit lidhur me problemet dhe katrahurat nëpër të cilët kaloi Kosova gjatë viteve '90. Në librin e tij edhe ky autor i kushton hapësirë mjaftë të madhe pikërisht këtij fenomeni të helmimeve masive të rinisë më 1990.

Konsideroj se mbi bazë të këtyre publikimeve dhe dokumenteve e prova të tjera, Qeveria dhe institucionet e Kosovës duhet të gjejnë mënyrën më të mirë për të ndriçuar këtë ngjarje përmes një komisioni ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ndoshta kjo mund të jetë edhe një nga detyrat e para të Institutit për Hulumtimet e Krimeve që është themeluar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Dhe unë propozoj që te ky komision të krijohet një ekip apo një komision me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë nga fusha e mjekësisë, toksikologjisë dhe hulumtimit të krimit.

Duke ju falënderuar për vëmendjen tuaj, më lejon që në fund këtë publikim dhe këtë letër përcjellëse e cila është dashtë të vijë të ju por s'di pse s'ka ardhur, por ka ardhur vetëm publikimi t'ia drejtoj edhe kryeministrit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të grupeve, nuk kemi të paraqitur.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Bošnjačka zajednica zauzima demokratski integrativni deo kosovskog društva na celokupnoj teritoriji naše države. Kao poslanik u Parlamentu Kosova, ispred bošnjačkog naroda ne dozvoljavam i ne dajem pravo da se ovo

stanovništvo zloupotrebljava u bilom kom pogledu sa bilo koje strane, jer u ovom trenutku na teritoriji opštine Mitrovica i Leposaviću posebno u pograničnim selima, gde se ljudi bore za opstanak svog života 24 časa, neko može izgubiti život zbog naših reči progovorenih u ovoj sali. Predlažem na tolerantnost i dobre međunacionalne odnose svih zajednica koji žive na teritoriji Republike Kosova.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Justina Pula-Shiroka.

JUSTINA PULA- SHIROKA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Ndjej për detyrë të vazhdoj të shpreh brengën dhe mendimin tim profesional si ekonomiste për çështje të rëndësishme të sektorit energjetik si dhe të propozoj atë që mendoj se duhet ndërmarrë rreth projektit të termocentralit “Kosova e Re”, veçanërisht për përllogaritjen e vlerës reale të termocentralit “Kosova B”. Mendoj që çështja më diskutabile që ndikon në mospjeksin e projektit “Kosova e Re” është përfshirja e termocentralit “Kosova B” në pako, për këto arsye:

1. Termocentrali “Kosova B” u fut në pako me termocentralin “Kosova e Re” në Kuvendin e Kosovës, nën presionin e jashtëm, jashtë parashikimeve të strategjisë 2009 – 2018 dhe pas një analize ekonomike reale.
2. Futja e termocentralit “Kosova B” në projekt e ka komplikuar projektin, si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe ajo financiare.
3. Politika ekonomike e dizajnuar, që çmimi i energjisë së prodhuar nga termocentrali “Kosova B” të jetë më i ulët se çmimet e tregut, është politikë e cila i dëmton interesat ekonomike të Kosovës.

Zvogëlimi i çmimit, zvogëlon fitimin dhe si pasojë zvogëlon aksionet në termocentralin “Kosova B” në projekt.

Çmimi i ulët i termocentralit “Kosova B” do të balancojë çmimin e shtrenjtë të energjisë nga termocentrali “Kosova e Re” i cili do të jetë mbi 80 euro për megavat. Kjo politikë krijon detyrime financiare të rënda për Qeverinë në të ardhmen.

Nën 4, aktualisht baza ligjore për projektin Termocentrali “Kosova e Re” është jo plotësisht e qartë, sidomos kur janë në pyetje Ligji i partneritetit publiko - privat dhe Ligi i minierave dhe mineraleve, pra dy ligje shumë të rëndësishme për Termocentralin “Kosova e Re”.

Opsionet që unë mendoj se duhet të konsiderohen para se të merren qëndrimet përfundimtare për finalizimin e tenderit për projektin “Kosova e Re”, janë dy:

1. Vlera e Termocentralit “Kosova B” të vlerësohet sipas kushteve të tregut të lirë të energjisë në rajon dhe në Evropë, ose

2. Termocentrali “Kosova B” të mbetet jashtë pakos tenderuese apo të mbetet jashtë pakos në Termocentralin “Kosova e Re”.

Parimet e tregut duhet të jenë bazë për vlerësimin e Termocentralit “Kosova B”. Ky parim duhet të jetë në themel të projektit si rrugë e vetme për projekt dhe për zbatimin me sukses.

Në përfundim, mendoj se projekti “Kosova e Re” dhe privatizimi i distribucionit të KEK-ut, janë çështje strategjike ekonomike, pra është koha që Kuvendi të sjellë vendime të rëndësishme lidhur me zhvillimin kapaciteteve të reja gjeneruese dhe të marrë përgjegjësitë të cilat i takojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ngrejë një çështje që ka të bëjë me politizimin që po i bëhet jetës tonë në përgjithësi, në këtë rast - sportit.

Ajo që ka ndodhur ditëve të kaluara në Klubin basketbollistik “Prishtina”, është shqetësuese, e pakuptimtë dhe e papranueshme që në emër gjoja të shpëtimit nga shuarja e Klubit basketbolistik “Prishtina”, synimi po del që ka qenë dhe është marrja e Klubit basketbolistik “Prishtina” nga politika, gjegjësisht një ministër i PDK-së, pra PDK-ja, sepse ndryshe nuk mund të kuptohet, zoti kryeministër, me qenë se jeni këtu, që një ministër nuk zgjedh metoda, ai dhe disa argatë të tij, që të zgjidhet kryetar klubi në mënyrë jo legjitime dhe në atë mënyrë, po të zbatoheshin procedurat, është e papranueshme që ministri, në këtë rast zoti Stavilevci, të jetë kryetar i një klubi të qytetit që është klub i qytetarëve të Prishtinës dhe nuk është klub i Qeverisë.

Të nderuar deputetë,

Nuk po më mbetet asnjë sferë e jetës që nuk po politizohet, në këtë rast sporti, gjegjësisht basketbolli. Përgjegjësinë për atë që po ndodhë dhe mund të ndodhë në Klubin basketbollistik “Prishtina” dhe në mesin e tifozëve “Plisat”, përgjegjësinë direkte do ta ketë zoti Stavilevci dhe PDK-ja, nëse nuk distancohet nga ajo që po bën ky njeri nëse del qartë që “nëna parti” nuk është pas tij. Ministër, para dite, e kryetar klubi pasdite, nuk mund të jetë askush, nuk shkojnë. Sporti është i të gjithë qytetarëve, në këtë rast i qytetarëve të Prishtinës. Klubi nuk është qeveritar, nuk është i një partie apo një ministri.

Nëse zotit Stavilevci i ka mbetur merak, duhet të japë dorëheqje e pastaj të konkurrojë për kryetar klubi, është shumë normale, shumë e logjikshme. Ata jo që penguan gjoja shuarjen e klubit, por po tentojnë t’ia vejnë flakën klubit më të trofeshëm, flakën politike

dhe partiake, këto i di dhe i sheh opinioni. Kjo që ka ndodhur, sigurisht që do të zë vend në Raportin e ardhshëm të Progresit, se ne këtu çdo gjë e politizojmë.

Zoti kryeministër, kërkoj nga ju që t'i ndalni ministrat tuaj ose secili ta merr nga një klub në qytete të ndryshme, sepse kjo logjikë është e dëmshme për qytetarët. Për të mos lënë hapësirë për të tjerët, 10 vite jam një ndër përkrahësit pas lufte të sportit, por asnjëherë nuk kam pranuar, as nuk pranoj të jem kryetar klubi apo drejtor me të vetmin qëllim që të mos politizohet. Si mund të zgjedhjet dikush, zoti kryeministër, kryetar me marrëveshje të ashtuquajtura gjentëlmene e jashtë procedurave?

Unë ju lus që, për hir të qytetarëve të Prishtinës, të ndikoni që atje të mos ndodhin gjërat të cilat me tentime dhe me qëllime...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Koha është harxhuar. Vazhdojmë. Fjalën e ka kryeministri ...

(Reagime nga salla)

..30 minuta është, mateni kohën! Koha është harxhuar.

(Reagime nga salla)

Jo, shumë faleminderit! Ju flisni sa të doni, fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuari i Kuvendit, zoti Krasniqi!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të filloj këtë adresim timin, duke iu uruar juve, deputetë të nderuar të Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe të gjithë qytetarëve tanë lajmin e shumëpritur rreth lansimit të dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për procesin e liberalizimit të vizave deri në fund të vitit, gjë që është konfirmuar zyrtarisht dje nga Komisioni Evropian.

Unë e di se, ashtu siç e dini edhe ju, njësoj sikur të gjithë qytetarët e Kosovës i gëzohemi këtij lajmi pozitiv që shënon momentin kyç për të ardhmen evropiane të shtetit tonë. Kjo e arritur dhe progresi që do të arrihet në të ardhmen, paraqet një avancim të integritetit evropian dhe njohje të punës që është duke u bërë nga Qeveria e Kosovës në këtë drejtim.

Më lejoni që t'i falënderoj të gjithë akterët shoqëror, institucionet qendrore, nivelin komunal dhe shoqërinë civile, mediat për kontributin dhe punën e tyre në procesin e liberalizimit të vizave. Si kryeministër i Republikës së Kosovës, jam i vendosur të

vazhdoj edhe më fuqishëm në përmbushjen në afat rekord të të gjitha parakushteve në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

Edhe pse në vitin 2011, jemi përballur me një proces të stërzgjatur elektoral, që është përcjellë me sfidën e konsolidimit të institucioneve shtetërore, Komisioni Evropian ka vlerësuar se Qeveria ka demonstruar përkushtim të fuqishëm ndaj procesit të integritit evropian.

Strategjia e zgjerimit ka rikonfirmuar agjendën evropiane të Kosovës në vazhdimin e mbështetjes së dy proceseve kyçe - liberalizimin e vizave dhe marrëveshja tregtare.

Zgjedhjet e vitit të kaluar, përkundër organizimit të kënaqshëm në një kohë të shkurtër, kanë vë në pah një numër të të metave të gjithmbarshme të gjithë spektrit politik, të cilat jemi duke i adresuar tanimë së bashku, edhe Qeveria, edhe Kuvendi, pozitë-opozitë, shoqëria civile, në mënyrë që reforma zgjedhore të jetë produkt i kontributit gjithëpërfshirës. Si çdo vit, Qeveria e konsideron Raportin e Progresit udhërrëfyes kyç për ndërmarrjen e reformave të përgjithshme, me qëllim të avancimit në procesin e integritit. Raporti shënon një moment të ri për intensifikimin e reformave strukturore në udhëtimin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Komisioni Evropian ka vlerësuar progresin në përmbushjen e kriterëve politike. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është karakterizuar me miratimin e ligjeve kyçe për luftimin e këtyre dukurive, fuqizimin e institucioneve të rendit dhe ligjit dhe ndërmarrjen e operacioneve policore.

Në fushën e prokurimit publik, tash ne kemi miratuar Ligjin e ri për prokurim publik, në harmoni të plotë me rekomandimet e Komisionit Evropian, duke e ngritur kështu përgjegjësinë e drejtpërdrejtë politike për menaxhimin e parasë publike.

Vazhdimi i reformave në sistemin gjyqësor ka shënuar progres të konsiderueshëm, me ç'rast është miratuar legjislacioni implementues dhe ka vazhduar procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për pozitat e mbetura. Siç jeni në dijeni, janë funksionalizuar institucionet për menaxhimin e sistemit gjyqësor, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial i Kosovës, si dhe janë përmirësuar kushtet fizike dhe materiale të gjyqtarëve, me ç'rast janë trefishuar të ardhurat për gjyqtarët dhe prokurorët. Kanë filluar punimet për ndërtimin e pallatit të Drejtësisë, në vlerë prej 25 milionë euro dhe të Prokurorisë shtetërore i janë ndarë hapësirat e nevojshme për funksionimin adekuat.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, Qeveria ka miratuar vizionin ekonomik dhe planin e veprimt, kurse sa i përket mirëmbajtjes së politikës së qëndrueshme buxhetore, Qeveria dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë nënshkruar programin monitorues të stafit në qershor 2011. Bruto produkti vendor për kokë të banorit ka shënuar rritje, duke arritur në vlerën prej 2835 euro në vitin 2010.

Në pjesën e parë të vitit 2011, eksportet kanë përformuar në mënyrë impesive duke u rritur për 36%. Nga kjo rritje eksporti, në vendet e Bashkimit Evropian kemi shënuar

rritje prej 84%, ndërsa 33% në vendet e CEFT-as. Rritja mesatare e çmimeve ka qenë 3.5% në vitin 2010, kjo si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit dhe derivateve të naftës në tregun botëror.

Gjatë vitit 2010, investimet e huaja kanë shënuar rritje prej 7.5% të bruto produktit vendor. Sa i përket performancës së të hyrave buxhetore, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, progres është arritur në rritjen e shkallës së grumbullimit të të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës 32% rritje dhe doganat 20% rritje. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është vazhduar me progres edhe në privatizim dhe me realizimin e projekteve infrastrukturore. Në anën tjetër, Raporti i Progresit ka evidentuar edhe një numër të sfidave kyçe për Kosovën, të cilat jam optimist se do t'i tejkalojmë bashkërisht.

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2011 dhe vitit 2012, Qeveria do të dëshmojë qasje proaktive në adresimin e sfidave dhe të rekomandimeve që dalin nga Raporti i Progresit. Në këtë drejtim, sot, gjatë takimit të veçantë që do të mbahet të Këshillit Ministror për Integrim Evropian, Qeveria do të dalë me objektivat kryesore me qëllim të adresimit të sfidave të Raportit të Progresit. Po ashtu, deri në përfundim të këtij viti Qeveria do të miratojë Planin e rishikuar të veprimit për partneritet evropian, me qëllim të dizajnit të të gjitha aktiviteteve konkrete.

Duke njohur nevojën për ndërtimin e konsensusit të gjerë politik dhe shoqëror për ndërmarrjen e reformës strukturore, institucionet e Kosovës do të themelojnë shpejt Këshillin kombëtar për integrim evropian, me qëllim të hartimit të Strategjisë afatgjate për integrim të Republikës së Kosovës në Bashkim Evropian.

Dëshiroj të përmbylli me nënvizimin e tri prioriteteve kryesore të Qeverisë, të cilat do të udhëheqin angazhimin e Qeverisë deri në publikimin e Raportit të ardhshëm të Progresit, e që në fakt janë: sundimi i ligjit, sundimi i ligjit, sundimi i ligjit për Kosovën evropiane.

Të nderuar deputetë,

Duke u pajtuar plotësisht me mesazhin kryetarit të Parlamentit, zoti Krasniqi, që fillimisht të lexohet Raporti i Progresit, pastaj jam në favor që të diskutojmë gjerësisht, t'i nxjerrim, të bëjmë edhe vlerësimin e të arriturave, por në të njëjtën kohë t'i nxjerrim edhe sfidat e përbashkëta që dalin për vitin e ardhshëm. Ritheksoj edhe një herë, ky sukses për liberalizimin e vizave, për dialogun për liberalizimin e vizave është sukses i shtetit tonë, është sukses i përbashkët, është sukses i Qeverisë, i pozitës, i opozitës, i autoriteteve komunale dhe i të gjithë njerëzve kontribuues. Ndërsa, sa i përket çështjeve që i ngritët, i nderuari kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, basketbollin mendoj se edhe ju, edhe unë duhet t'ia lëmë basketbollistëve dhe jo politikës. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës

(Reagime në sallë)

KRYESUESI: Unë mendoj që kryeministri u përgjigj konform debatit që u zhvillua më herët. Mirë, zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues, Haliti,
Zoti kryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Më së pari, nuk është mirë as kryetari i Kuvendit, as kushdo qoftë të paragjykojë se kush e ka lexuar atë tekst të Komisionit Evropian, se nuk është testuar. Unë po ju them që e kam lexuar, por nuk është me rëndësi kjo, sepse unë mund ta paragjykoj që nuk e ka lexuar kushdo qoftë në atë formë, kështu që nuk është mirë kështu të bisedohet për një dokument tepër të rëndësishëm.

E dyta, sa i përket pikërisht Kuvendit dhe raportit me Qeverinë, janë dy elemente që theksohen dhe kjo na takon neve që sot këtu. Kuvendi nuk e kryen punën si duhet në kontrollin e ekzekutivit dhe, e dyta, Qeveria nuk merr pjesë në Kuvend. Prandaj, duke i pasur parasysh pikërisht këto nënvizimet e Raportit për Kuvendin, po, po, te pjesa e Kuvendit, unë i kam letrat, pra që për këtë temë që është shumë e madhe, shumë e domosdoshme për Kosovën, që tash të caktohet një mbledhje e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën do të marrë pjesë e tërë Qeveria, me të gjithë resorët dhe këtu të ballafaqohen me ndodhitë dhe me pritjet. Përndryshe, deklaratimet solemne qofshin të kryeministrit, të cilat, normalisht, e kanë edhe notën propagandistike të punës së vet, sepse përndryshe nuk ka pse të dalë të flas, të kalojmë në analiza konkrete dhe nuk ka nevojë të themi - a kemi të drejtë të deklarojmë tash apo jo. Ky Kuvend, në mbledhjen e ardhshme, unë mendoj që duhet ta ketë një temë të rendit të ditës, formalisht kjo mund të kërkohej prej grupit tonë, por unë mendoj që nuk ka pse të kërkohej, të merremi vesh dhe të diskutojë i gjithë Kuvendi me gjithë Qeverinë për të gjithë resorët, atëherë nuk ka mundësi që të flasim në mënyrë propagandistike as Qeveria, as Kuvendi.

Unë edhe njëherë po them, kryeministri është detyrë e tij, se është kryetar Qeverie dhe nënvizon suksese, poenë Qeverisë, është punë e tij. Por, unë kërkoj mbledhje, sepse as Qeverisë nuk i bëjnë punë poenët pozitivë, këtu e tutje, për një vit po, po, i bën punë analiza e mungesave edhe Qeverisë, edhe Kuvendit, edhe shoqërisë së Kosovës, edhe shoqërisë civile dhe gjithë asaj që na pret. Prandaj, zoti kryesues, e lypa fjalën, se nuk ka metodë qysh të diskutohet kur i adresohet kryeministri ose ministrat Kuvendit. Është punë tjetër, ajo mund të precizohet me atë rregullore, që aty ku Qeveria artikulohet politikisht për program, është e drejta normale e opozitës që ta marrë fjalën. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti kryeministër e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë, përsëri e ndaj mendimin e njëjtë me kryetarin e Parlamentit, zoti Krasniqi, siç pajtohem plotësisht me qasjen e zotit Hamiti, gjithashtu, dhe ishte edhe vet kërkesë e imja, si kryeministër i Kosovës, në emër të Qeverisë që në

moment që përgatitet Kuvendi, në një seancë, në të ardhmen menjëherë apo kur e cakton datën, është çështje e Kryesisë, unë dhe e gjithë Qeveria do të jemi në Kuvend për të marrë pjesë aktive në debat, një debat që mendoj që do t'i shërbente qartësimi të rrugës sonë evropiane. E ritheksoj edhe një herë, unë isha iniciues i një debati të gjithë spektrit politik përfaqësues në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nga ai debat do të fitonim të gjithë, duke e bërë një vlerësim real, por edhe në të njëjtën kohë duke nxjerrë përgjegjësi të reja të përbashkëta.

Është fat për të gjithë Kosovën, që i gjithë spektri politik kosovar ka një konsensus sa u përket disa çështjeve, e në veçanti perspektivës evropiane, kështu që e ritheksoj edhe një herë, nuk është çështje e ekzagjerimit të suksesit apo jo. Është raport i progresit faktik dhe real dhe unë vetëm e ritheksoj atë që e prezantuan edhe dje përfaqësuesit e Komisionit Evropian. Qeveria e ka bërë punën e vet, opozita duhet të punojë më mirë dhe më shumë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas Rregullores së Kuvendit dhe Kushtetutës, kryeministri ka të drejtë ta thërras seancën. Duhet ta bëjë me shkrim, ashtu edhe deputetët duhet ta bëjnë me shkrim dhe Kryesia ta caktojë datën e debatit, në qoftë se kërkohet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që është:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve, është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashtojë më së shumti dy pyetje.

Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani. Regjia, deputetes Breca fjalën, ju lutem!

NAZANE BRECA: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kujdesi parësor shëndetësor është gur themel i të gjitha sistemeve shëndetësore, po mendoj edhe në vendet tjera. Kujdesit parësor shëndetësor duhet t'i kushtohet një rëndësi e madhe në qoftë se dëshirojmë që sistemi shëndetësor në përgjithësi të ketë sukses. Në vendet e zhvilluara, kujdesit parësor shëndetësor i kushtojnë rëndësi të madhe, gjë që shihet edhe nga buxheti i cili i ndahet që në fillim kujdesit parësor shëndetësor, që është kryesisht më tepër se gjysma nga buxheti i përgjithshëm që ndahet për shëndetësi. Kjo te ne nuk ka ndodhur edhe prej pas luftës e deri më tash është parë që me të vërtetë, në njëfarë mënyre mund të them se është neglizhuar kujdesi parësor shëndetësor, nuk i është kushtuar rëndësia e cila duhet t'i kushtohet për shkak se, në qoftë se ne dëshirojmë të kemi një sistem shëndetësor të zhvilluar, të avancuar, duhet t'i kushtojmë një rëndësi të madhe edhe t'i ndahet një buxhet të cilin e

meriton kujdesi parësor shëndetësor. Se sa i është kushtuar rëndësi, shihet edhe nga ajo se ende ne nuk kemi një ligj për kujdesin parësor shëndetësor. Andaj, pyetja ime për ju, zotëri ministër, është se kur pritet draftimi dhe nxjerrja e Ligjit të kujdesit parësor shëndetësor?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pajtohem me ju plotësisht kur e vlerësoni rëndësinë e kujdesit parësor shëndetësor dhe besoj se edhe ju pajtoheni me mua se pozita e tanishme e këtij sistemi, të këtij niveli të shërbimeve shëndetësore është rezultat i sistemit aktual shëndetësor, i cili de fakto me ndarjen e nivelit parësor, nën përgjegjësinë e komunave, dhe nivelit dytësor dhe tretësor, nën përgjegjësinë e Ministrisë, e ka shkaktuar një çrregullim të dukshëm edhe në sistemin e referimit, edhe në sistemin e financimit të këtyre shërbimeve.

Rrugëdalja prej kësaj situatë, janë zgjidhjet ligjore të cilat janë projektuar në Projektligjin për shëndetësi, i cili integron shërbimet e nivelit parësor me shërbimet e nivelit dytësor dhe tretësor në kuadër të shërbimit kombëtar të shëndetësisë dhe vendosja e marrëdhënieve të kontraktualitetit dhe financimit të sektorit të shëndetësisë nëpërmjet të Fondit të sigurimeve shëndetësore. Me këtë, me siguri do të arrijmë edhe ngritjen e financimit të kujdesit parësor, sepse pajtohem plotësisht që në atë nivel duhet investuar më tepër, në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

Ligj i veçantë për kujdesin parësor shëndetësor nuk është paraparë në agjendën legjislative të Ministrisë. Ekziston Udhëzimi administrativ për organizimin e shërbimeve të mjekësisë familjare, që është themeli i shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, dhe unë mendoj se rruga e drejtë është fillimisht që të riorganizojë sistemin aktual me një sistem të ri të shëndetësisë kosovare, të gjejmë vendin e duhur për kujdesin parësor shëndetësor e më pastaj të gjejmë zgjidhje konkrete ligjore, në qoftë se paraqiten nevojat për këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë? Deputetes Breca, fjalën!

NAZANE BRECA: Zoti ministër,

Në përgjithësi, buxheti ndahet në nivel qendror, do me thënë, për kujdesin parësor shëndetësor edhe ajo mandej përcillet në nivelin komunal, kështu që mu prej kësaj edhe varet se sa zhvillohet kujdesi parësor shëndetësor. Unë desha t'ju them se, nuk di se sa keni njohuri se Grupi punues në kuadër të Ministrisë për Shëndetësi ka punuar në lidhje me këtë ligj dhe drafti i këtij ligji gjendet diku në sirtarët e Ministrisë për Shëndetësi. Ma merr mendja që ndoshta kishte me qenë mirë për ta proceduar, se jemi i vetmi vend në rajon i cili nuk e kemi Ligjin për kujdesin parësor shëndetësor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti, ministër!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete, Unë e thashë se në agjendën legislative të Qeverisë, ky ligj nuk është i paraparë si dokument zyrtar dhe mendoj se ka ardhur koha kur duhet ndërprerë puna në ligje pragmentare, në ligjet të cilat organizojnë dhe rregullojnë segmente të caktuara në sektorin e shëndetësisë. Fillimisht dua t'i qasemi rregullimit të sistemit shëndetësor, riorganizimit të tij e më pastaj të shkojmë edhe në rregullimin e segmenteve të caktuara të sistemit. Besoj se pajtoheni në këtë pikë, natyrisht duke mos e zhvlerësuar aspak rëndësinë të cilën po ia jepni kujdesit parësor.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputetja Breca, prapë pyetje për ministrin Agani.

NAZANE BRECA: Ju faleminderit!
Shpesh herë nëpër institucione shëndetësore ndonjëherë ekziston një parregullsi edhe përzjerje e kompetencave të punëtorë shëndetësorë në vendet e punës. Pyetja ime është se kur pritet fuqizimi dhe aprovimi i urdhrat të mjekut dhe të infermieres që kishte për të rregulluar dhe specifikuar detyrat e secilit punëtor shëndetësor në vendet e tyre të punës.

KRYESUESI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Ky detyrim ligjor ka ekzistuar që nga viti 2004 edhe me Ligjin aktual të shëndetësisë, pra Ligjin për shëndetësi, i cili ka paraparë formimin e Këshillit të përgjithshëm profesional dhe më pastaj urdhrave profesionale, por deri më tani kjo asnjëherë nuk ka arritur që të realizohet, pra kjo dispozitë ligjore nuk ka arritur të zbatohet për shumë shkaqe. Atë që kemi bërë si ministri në këtë periudhë kohore, është se e kemi mbajtur muajin e kaluar Kuvendin nismëtar të odave të profesionistëve shëndetësorë, pra të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve dhe infermierëve dhe atë nën mbikëqyrjen, më mirë të themi, bashkëpunimin me Federatën e odave gjermane shëndetësore, të procesit shëndetësor dhe aktualisht procesi është në fazën e emërimit të këshillave organizativ për mbajtjen kuvendeve themeluese të këtyre odave, të cilat do të konstituohen në mënyrë ligjore pas miratimit të Ligjit të shëndetësisë, i cili unë pres shumë shpejt të vjen në Kuvendin e Kosovës.

KRYESUESI: Pyetje shtesë? Deputetes Breca fjalën!

NAZANE BRECA: Unë vetëm desha të plotësoj edhe këtu se prapë mund t'ju them se jemi i vetmi vend në rajon që nuk e kemi ende urdhrin e mjekut dhe të infermieres. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Thaçi. A dëshironi ta bëni pyetjen?

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Është hera e dytë që e bëj këtë pyetje dhe në momentin që më vjen koha për të bërë pyetjen, kryeministri del nga sallat. Më lejoni t'ju kujtoj që pikërisht në Raportin e Progresit, një nga vërejtjet kryesore është që ministrat nuk marrin pjesë në seanca plenare, ndryshe nga sot, si duket ka bërë pak efekt, por si duket efekti nuk është bërë për kryeministrin. Dhe kjo është një ikje nga përgjegjësia publike. Sidoqoftë, unë do ta bëj pyetjen.

Kohët e fundit, nga komuniteti i gazetarëve gjithnjë e më shumë është vënë në dukje fakti që kryeministri ende nuk ka caktuar një zëdhënës dhe kjo është një pengesë serioze jashtëzakonisht e madhe për punën e gazetarëve, sepse ata nuk kanë mundësi të depërtojnë, të marrin informacionet e duhura nëpër institucione. Mendoj që bëhet në mënyrë të qëllimshme kjo, pra, pikërisht për të penguar punën e tyre.

Unë sërish do ta bëj pyetjen me shpresë se kryeministri do ta përmirësojë pra, meqë nuk marrim dot përgjigje, se kur do të caktohet një zëdhënës. Kemi parasysh që edhe qasja, Ligji për qasjen në dokumente zyrtare është një nga më të paimplementueshmit. Gazetarët kanë pengesa serioze për të marrë dokumente dhe për të pasqyruar për publikun, për të kryer misionin e tyre se si punon Qeveria. Cilat janë ato vendime që merren, janë ato në favor të publiku apo jo? Mendoj që kjo është një çështje shumë serioze dhe duke pasur parasysh edhe atë çfarë ka shkruar Raporti i Progresit, ku liria e mediave jo vetëm që nuk ka progres, por është e limituar dhe gazetaria investigative ka pengesa serioze, mendoj që kryeministri duhet t'i vejë gishtin në kokës në lidhje me këtë punë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Kuçi, zëvendëskryeministri dëshiron që të përgjigjet në vend të zotit Thaçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDINI KUÇI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Lama,

Me autorizim të kryeministrit, ju përgjigjem në pyetje dhe besoj që ka të drejtë edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Është e vërtetë se Qeveria nominalisht nuk ka zëdhënës, por në drejtim të asaj që i hapët disa tema, duhet të them që për transparencën është një veti e mirë që ne bëjmë mbledhje të hapura. Pastaj, pas çdo takimi të Qeverisë, kemi dalje të kryeministrit, timin apo dikujt tjetër para gazetarëve dhe me Rregulloren e Punës së Qeverisë kemi paraparë që njëri nga këshilltarët në secilën dikaster apo ministri, të luaj rolin e zëdhënësit.

Sa i përket çështjes që lidhet me qasje në dokumente zyrtare, nuk e di asnjë rast që ndokush, qoftë qytetarë apo nga mediat, nuk ka pasur mundësi që të ketë qasje në dokumente zyrtare dhe po ashtu duhet të them që adresimet e tilla janë obligative me ligj.

Sa i përket raportit me media, ne e lamë që të flasim një ditë në qasjen që kemi të bëjmë me Raportin e Progresit dhe jemi dakord për këtë, por gjithmonë kur flasim për

ndikimin e politikës, dua ta shohë më shumë se Qeverinë dhe politika në Kosovë nuk është vetëm Qeveria. Dhe, krejt në fund, po e them se shumë shpejt, besoj, kryeministri do ta emërojë dikën për zëdhënës të Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë? Deputetes Lama, fjalën!

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni t'i sqaroj zëvendëskryeministrit që paraqitjet e juaja publike dhe deklaratat e juaja publike nuk janë thjeshtë qëndrime publike dhe nuk janë informacion i mirëfilltë që kërkojnë qytetarët. Zëdhënësi është pengesë, ua shpjegoj pse është pengesë. Ata kanë nevojë të shkojnë dhe të komunikojnë me zyrtarët e tjerë. Këshilltarët që ju i keni caktuar, nuk e bëjnë këtë punë dhe më lejoni të t'ju them që në mënyrë të qëllimshme bëhet kjo për të penguar punën e tyre. Përse ju nuk e adresoni shqetësimin e komunitetit të gazetarëve? Ata po ankohen për këtë, pra është bërë pengesë serioze kjo çështje.

Për sa i përket Ligjit për qasje në dokumente zyrtare, ju thoni që nuk ka asnjë gazetar. Unë vet kam bërë hulumtim në lidhje me këtë çështje dhe ky ligj zbatohet rreth 2 ose 3%. Lexojeni dhe Raportin e Progresit dhe do të shihni që Ligji është në fillim të implementimit. Pra, gjendja është shumë e rëndë. Dokumentet zyrtare, qasja në dokumente zyrtare është shumë e rëndësishme, sepse gazetarët nuk kanë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Edhe një minutë, shtojani! Zoti Kuqi e ka fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUQI: Ju faleminderit!

Mendoj që puna e zëdhënësit, që nganjëherë dalim ne para mediave më shumë se sa zëdhënësi dhe zakonisht unë nuk dua ta mbiçmoj veten, por qëndrimet kur i them, i them të harmonizuara dhe nuk demantohen prej Qeverisë, unë jam i kujdesshëm në këtë drejtim.

Unë nuk them asnjë rast që mungesa e zëdhënësit është diçka pozitive. Përkundrazi, do ta marrim obligim që ta gjejmë një person adekuat, qoftë vajzë apo djalë, që do të jetë i pranueshëm për komunitetin e mediave, por njëkohësisht edhe për politikën e Qeverisë. Në anën tjetër, po e them prapë, unë nuk di një rast, qoftë ju apo dikush tjetër që ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare dhe nuk ka pasur një qasje të tillë, me përjashtime që ka paraparë ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Lutfi Haziri ka një pyetje. Nuk është këtu as deputeti, as kryeministri. Prapë Lutfi Haziri për Memli Krasniqin, asnjëri nuk janë këtu.

Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryesues!

Krimi i organizuar në Kosovë nuk po ndalet, por po përparon edhe dukshëm në segmentin më të ndjeshëm, siç është shëndetësia, e cila prek qytetarët e të gjithë vendit tonë.

Çështja është vjedhja e kompjuterit, me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me regjistrimin e barërave në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale.

Zoti ministër, pyetja për ju është: Çka keni ndërmarrë me këtë rasat, cilat janë pasojat dhe a është rrezikuar shëndeti i qytetarëve të vendit tonë, duke marrë parasysh që me këtë vjedhje mund të ndodhin manipulime me barërat e caktuara?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINSITRI FERID AGANI: I nderuari zoti deputet, Edhe nëndaj shqetësimet tuaja lidhur me dukuritë e shumta negative që e kanë kapluar sektorin farmaceutik në vitet e fundit. Rastin konkret, natyrisht ne i kemi informuar organet hetimore që e kanë bërë punën e tyre dhe janë duke e bërë punën e tyre. Ajo që mund t'ju informoj është se të gjitha të dhënat të cilat kanë qenë në atë kompjuter, janë siguruar, pra janë në Agjencionin Kosovar të Produkteve Mjekësore, asnjëri prej tyre nuk mungon dhe sipas këtyre të dhënave, shihet se nuk bëhet fjalë për asnjë rrezikim të shëndetit të qytetarëve.

Sipas informatave zyrtare që unë i kam, ka qenë fjala për një llap-top, i cili ka qenë i vetmi në ato hapësira dhe është bërë fjalë për një vjedhje të thjeshtë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë, zoti deputet? Deputetit Zemaj, fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Zoti ministër, nëse ju e konsideroni vjedhje të thjeshtë, si ndodhi që një javë pas të vidhen barërat po në të njëjtin vend, nëse aq janë masat e sigurisë, është vjedhur kompjuteri, pastaj janë vjedhur barërat. Dhe, e dyta, në faqen 40 të Raportit të Progresit thuhet shumë qartë: “Lufta kundër keqpërdorimit të barërave ende nuk është adresuar dhe ende nuk janë ndërtuar politikat për parandalimin e këtij krimi që është shumë i organizuar në Kosovë”

E treta, një dokument i cili është dalë nga Inspektorati i juaj i brendshëm shumë qartë e thekson se ka shitje të barnave pa banderola, si dhe posedim të paligjshëm të barërave, të listës esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë, të dedikuara për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Mua më vjen keq nëse këto janë të thjeshta, por për qytetarët e vendit, për mua si deputet dhe për Qeverinë duhet të jenë shumë serioze dhe të luftohet në mënyrën shumë më efikase dhe jo të kemi vetëm ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, e dëshironi fjalën? Ministrit Agani, fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti deputet,
Rasti i parë dhe rasti i dytë janë dy dukuri kriminele, dy vepra penale që janë kryer në të njëjtin institucion, por nuk kanë lidhje njëra me tjetrën.

Bëhet fjalë për vepra penale të cilat janë në procedurën e hetimeve dhe ne do t'i shohim rezultatet e tyre më vonë. Unë e pata qëllimin t'ju theksoj se të dhënat që kanë qenë në atë lap-top nuk paraqesin rrezik për shëndetin e qytetarëve.

E dyta, çështja e vendosjes së mekanizmave për parandalimin e keqpërdorimit të barnave, unë dua t'ju them me përgjegjësi të plotë se ne këto mekanizma kemi filluar t'i ndërtojmë nga Ministria e Shëndetësisë e tutje dhe natyrisht se në këtë proces kemi edhe shumëçka për të bërë. Është instaluar softueri i veçantë, i cili e ka regjistruar çdo hallkë të procesit të distribuimit të barnave prej depos qendrore e deri te institucionet shëndetësore dhe është duke u punuar në këtë drejtim.

Por, edhe fakti tjetër është se ju po e shihni që sa muaj u bë dhe është shumë vështirë edhe të emërohet një kryeshef i Agjencionit Kosovar për Produkte Mjekësore, flet për atë se shumë ka vështirësi në këtë segment dhe ka shumë grupe të interesit të cilat janë të ndërlidhura me këtë sektor.

Unë jam kah e bëj maksimumin, por ju e dini se procesi i emërimit nuk është në duar të Ministrisë së Shëndetësisë, por kemi të bëjmë me një zinxhir i cili duhet të elaborohet dhe të funksionojë në bazë të ligjit. Dhe, në këtë drejtim jam i vendosur që të vëmë rregull e rend dhe jam i bindur se do të arrijmë edhe këtë ta bëjmë.

Kur është në pyetje, pyetja e fundit që ishte për shitjen e barnave, mu këtu dua të theksoj se ky rezultat, ky raport që ju e keni marrë, është rezultat i punës tonë dhe e angazhimit tonë si Ministri. Në muajt e fundit, ... po ju them, do të thotë Inspektorati shëndetësor dhe Inspektorati farmaceutik funksionojnë së bashku. Janë nën mbikëqyrjen edhe të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Po, përgatitu, vëlla! Ministri, edhe një minutë!

MINISTRI FERID AGANI: Janë pyetje të cilat janë për herë të parë të shtruara. Do të thotë, është çështja se ky raport që e keni parë ju, është rezultat i punës së këtyre inspektorateve dhe këto inspektorate kanë marrë masa konkrete të dënimeve të këtyre institucioneve dhe individëve të cilët do të dërgohen në procedurat gjyqësore për shkeljet që i kanë bërë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Radojica Tomiq. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta lexoni pyetjen? Deputetit Neziri, fjalën!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pasi ministri nuk është këtu, unë do ta bëj pyetjen se i kemi dy zëvendëskryeministra, me siguri ia përcjellin ministrit.

Kjo është pyetja, se Ministria për Komunitete dhe Kthim po e zvarrit implementimin e programit për kthim dhe kësaj ministrie i është ndarë një buxhet për 7 milion që nga fillimi i vitit dhe 2 milionë janë ndarë për ndërtime dhe ende nuk ka filluar, është muaji 10 dhe ende s'ka filluar për t'u marrë me ndërtim. Kështu që vetëm e ka krijuar një task-forcë që përbëhet nga UNHCR-i, Ministria për Komunitete, NDP-i dhe vetëm edhe NATO-n që s'e kanë shti në atë task-forcë dhe janë që 10 muaj duke u marrë me identifikimin e problemeve dhe ende s'kanë filluar ndërtimin e asnjë shtëpie, ndërsa njerëzit janë duke jetuar në kushte shumë të vështira.

Unë nuk di kur kjo Ministri do të fillojë, konkretisht të fillojë të veprojë ashtu qysh e ka paraparë me Kushtetutë dhe me ligjet tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri, nuk është! Mund t'ia bësh prapë pyetjen kur të vijë ministri!

Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Fehmi Mujota!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Ministria juaj po hetohet nga Prokuroria e Qarkut të Prishtinës për veprën e shpërdorimit të detyrës zyrtare të disa zyrtarëve tuaj, hetime këto që kanë çuar deri në mbylljen e Qendrës së patent-shoferëve në Prishtinë.

Sipas informatave, Ministria juaj i ka besuar një punë shumë të ndjeshme mikut tuaj, konkretisht vëllait të gruas tuaj, siç është shtypja e testeve për patent-shoferë.

Si e arsyetoni ju gjithë këtë absurditet para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës?

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, e nderuara deputete!

Po të ishit deputete e Partisë Demokratike, dikush do të mendonte si të koordinohet që të shtrohet kjo pyetje. Vërtet, falënderoj shumë! Por e dini ju që nuk është kështu, prandaj besoj se është i qartë pozicioni për të cilin po flasim.

Udhëheqësit e departamenteve të automjeteve dhe njësive të patent-shoferëve kanë raportuar në vazhdimësi për veprime jo ligjore në të gjitha qendrat e patent-shoferëve në Kosovë, si raste të ndërhyrjeve të personave të pa autorizuar, mesitët t'i quajmë në gjuhën popullore, kërcënimet, mit-marrjet, dalja e çelësit të testeve, korruptimi dhe arrestime të vazhdueshme të ekzaminerëve, përkatësisht pyetësve nga policia e Kosovës.

Si rezultat i këtyre veprimeve, gatishmëria e kandidatëve për patent-shoferë në nivel vendi ishte mbi 80%, të shumtën pa meritë dhe dije të nevojshme. Kandidatë që nuk kanë

ditur as shkrim as lexim, kanë marrë deri 100 pikë, përkatësisht 100% të tekstit e kanë plotësuar.

Kjo ka kushtuar pa siguri në komunikacion, të nderuar deputetë, dhe humbjen e jetës së njerëzve. Për këtë arsye, sipas përgjegjësive dhe obligimeve ligjore Ministria ka ndërmarrë veprime për parandalimin e këtyre dukurive, duke formuar komisionin profesional për përpilimin e testeve të reja për patent-shofer. Hartimi dhe shtypja e testeve është përgjegjësi e Ministrisë.

Për shkak të zvarritjeve të procedurave të prokurimit dhe anulimit të tenderit për shtypjen e testeve dy herë radhazi nga Departamenti i Prokurimit, Ministria është detyruar të bëjë zgjidhje të përkohshme për të siguruar shërbime të domosdoshme ndaj kandidatëve për patentë shoferë, në të kundërtën alternativë do të ishte ndërprerja e plotë e shërbimeve.

Në mungesë të pajisjeve, testet nuk kanë mund të shtypen në Ministri, përkatësisht dy fletë kolor, nga katër sa ka testi, janë shtypur përkohësisht në një shtypshkronjë në konfidençë, siç kërkohet me ligj.

Për këtë shërbim, ju bëj me dije se nuk është shpenzuar asnjë cent i buxhetit të Republikës së Kosovës. Përkundrazi, është dëmtuar pronari me 400 euro shërbim, sa ka bërë për Ministrinë dhe për tërë dijen jashtëzakonisht të mirë dhe për efektin që e ka dhënë.

Si rezultat i hapave të ndërmarrë, fillimisht përqindja e kalimit ka rënë, merreni me mend, në 10% e në disa raste ka pasur edhe 0%, asnjë kandidat nuk ka kaluar në qendrat e patent-shoferëve.

Por, tani është diku rreth 30%, që nënkupton se kanë filluar që kandidatët të mësojnë më tepër, të përgatiten më tepër dhe natyrisht efekti do të jetë shumë pozitiv.

Ju bëj me dije se këto veprime e kursejnë jetën e qytetarëve tanë dhe e rrisin sigurinë e njerëzve në përgjithësi, por këto veprime dikujt nuk i kanë konvencuar. Dhe me këtë janë goditur shumë individë që për përfitime të veta sfidojnë ligjin dhe institucionet e vendit. Ata kërcënojnë dhe dërgojnë letra anonime në adresa të ndryshme në polici, dhe për ne kjo nuk është diçka e papritshme, sepse ndërmarrja e veprimeve të tilla ka shqetësuar shumë njerëz që kanë bërë keqpërdorime të tilla.

Ne inkurajojmë organet kompetente dhe ofrojmë bashkëpunimin tonë të plotë për të sqaruar gjithçka lidhur me këtë rast dhe cilindo rast tjetër dhe jemi shumë të vendosur që të veprojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Deputetes Bajrami, fjalën!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, shumë ministër! Këtë përgjigje e lexova edhe në reagimin tuaj që e keni bërë ndaj gazetës “Zëri” në ueb-faqen tuaj. Nuk jam aspak e kënaqur!

Nuk bëhet fjalë këtu për shpërblim, se edhe aty thoni që shtypshkronja ka kryer punë me vlerë prej 400 euro dhe nuk është paguar asnjë cent. Çfarë Ministrie...! Ju e keni buxhetin më të madhin që e ka ndonjë ministri në Kosovë. Çfarë Ministrie jeni ju që nuk jeni në gjendje ta keni një fotokopje kolor e cila kishte për ta kryer këtë punë?

Domethënë, nëse janë shtypur që sa muaj në vlerë prej 400 eurove, ju këto dokumente duhet t’i keni konfidenciale.

Pyetja është, a e keni ditur ju që tenderi iu ka dhënë pikërisht vëllait të gruas tuaj?

Ju s’mund të mbërrini ta bindni as veten, e lëre më mua dhe qytetarët e Kosovës që këto teste nuk janë keqpërdorur. Këtu kemi nepotizëm, këto janë vërejtje të Raportit të Progresit, janë vërejtje që e ngremë ne për çdo ditë. Domethënë, nuk është e drejtë që vëllait të gruas tuaj, pa procedurat e prokurimit, t’i jepet një tender i tillë. Unë, kur e kam lexuar informatën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti, ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, sërish, e nderuara deputete! Pikërisht nuk është dhënë asnjë tender për mikun! Pikërisht është respektuar një konfidencialitet që është dashur të respektohet dhe procedurat e prokurimit janë vonuar për arsye për të cilat tash ka masa disiplinore në këtë ministri dhe ne po presim të gjitha hetimet e duhura.

Unë jam njeriu më i lumtur që çdo gjë të shkojë sipas procedurave, sipas ligjit dhe të vërtetohet çdo gjë rreth çdo çështje. Por, jam shumë i sigurt se kam ndal të keqen në këtë vend dhe unë uroj që ju të mos jeni të ndikuar vetëm nga gazeta “Zëri”, e cila nuk e publikoi reagimin e Ministrisë sonë, sepse po të jetë vetëm kështu, ndoshta do të jetë më lehtë për juve, por nëse jeni të ndikuar nga njerëzit të cilët kanë keqpërdorur këto gjëra dhe sot kemi një gjendje çfarë e kemi tek shoferët, të cilët nuk dinë të japin ndoshta shenjën në të djathtë e në të majtë, druaj se do të bëheni pjesë e mbrojtjes së të keqes ose pozicionim në anën e gabuar.

Unë jam i hapur për çdo gjë, për çdo procedurë të respektohet ligji, të vendoset rendi dhe vërtet të funksionojmë ashtu si duhet funksionuar, pa e keqpërdorur askush asnjë pozicion dhe asnjë mundësi që të ndikojë në jetën e qytetarëve të Kosovës në mënyrë të padrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Time Kadriaj pyetje për ministrin Ferid Agani.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pas shumë peripecive, Ministria e Shëndetësisë më në fund zgjodhi drejtorin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe kryeinspektorin shëndetësor, që janë sektor shumë të rëndësishëm.

Ministër, a mendoni se e keni bërë përzgjedhjen e duhur për këto dy poste dhe a mendoni se me këto zgjedhje do t'i stabilizoni në njëfarë mase problemet me të cilat po ballafaqohet shëndetësia?

KRYESUESI: Zoti, ministër e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara, zonja deputete!

Të nderuar deputetë,

Unë mendoj se është bërë përzgjedhja e duhur me siguri, meqenëse sipas vlerësimeve zyrtare janë respektuar të gjitha normat ligjore në procesin e përzgjedhjes dhe jam i bindur se këta kandidatë e kanë merituar, ndërsa në pyetjen e dytë se a mendon që kjo do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes ose, më mirë të them, në zgjidhjen e problemeve. Në përmirësimin e gjendjes me siguri po, sepse njerëzit e duhur, në vende të duhura me siguri se i duhen Kosovës, veçanërisht tash. Por se a janë këta persona ata që do t'i zgjidhin problemet, me siguri që jo. Sepse, këta janë vetëm pjesë të një sistemi anakronik, të një sistemi të pas luftës, i cili ende funksionon në shëndetësinë kosovare dhe ata si individë, madje edhe me mbështetjen e ministrit, në qoftë se e kanë mbrapa, nuk do të mund të bëjnë shumëçka, do të mund të ndryshojnë në rrafshin e politikave ditore, të jetës së përditshme, shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga dita në ditë, por nuk do të jenë në gjendje që të ndryshojnë diçka në mënyrë përmbajtjesore kur është në pyetje ngritja e vëllimit të punëve, cilësisë së punëve, pajisjeve të institucioneve shëndetësore me pajisje të duhura, me teknologji bashkëkohore, por në anën tjetër edhe përmirësimin, të marrim, të punës së Inspektoratit Shëndetësor, i cili sot i ka 7 punëtorë dhe i cili mund të ngritet me shfrytëzimin e të gjitha resurseve të brendshme në 10, 15 punëtorë.

Ne kemi bërë kërkesë me rastin e miratimit të Ligjit të shëndetësisë, si pjesë e kostos së ligjit, që të kemi të inkuadruar rreth 50 inspektorë shëndetësorë, me të cilët do të mund të kryejmë punën si duhet në tërë sektorin publik dhe privat të shëndetësisë.

Pra, nuk është çështje e individëve kjo, por kjo është çështje sistemore, por natyrisht se me punëtorët e duhur në vend të duhur gjërat do të realizohen më me sukses.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Deputetes Kadriaj fjalën!

TIME KADRIAJ: Me Ligjin e Inspektoratit shëndetësor janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e kryeinspektorit shëndetësor, të cilat janë detyra të shumta dhe përgjegjësi të shumta.

Tash kryeinspektorja është specializante, tash sa e ka marrë... sipas informacioneve. A do ta kryej punën e specializantes apo punën e krye-inspektorit, apo do t'ia lejonin të dyja, se janë ngjarje që ndodhin. Ose, zonja Baraku, dikujt nga stafi menaxherial në Ministrinë e

Shëndetësisë ia ka bërë ndonjë favor që e keni shpërblyer me postin e krye-inspektore. Apo tjetra, ndoshta, përvoja menaxheriale në UNMIK, ku ka punuar zonja Baraku, është aq e rëndësishme që menjëherë e keni shpërblyer me postin e krye-inspektore. Sepse, ka pasur kandidat të tjerë të cilët kanë pasur përvojë menaxheriale të shumta në shëndetësi, po që kanë qenë edhe punëtorët e Ministrisë së Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuar, zonja deputete, Krye-inspektorja shëndetësore e Kosovës do ta kryejë detyrën në pajtim me Ligjin për Inspektoratin shëndetësor dhe procedurën e seleksionimit. Sipas vlerësimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe të gjitha instancave ligjore ajo i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e nevojshme për t'u zgjedhur në atë post dhe unë nuk kam kurrfarë dyshimi që ajo do ta realizojë këtë detyrë në mënyrë të suksesshme.

Sa i përket supozimeve tuaja se dikush dikujt i ka bërë favore, këto le të mbesin tek ju. Ju është mirë që ato t'i argumentoni konkretisht. Unë ju garantoj se në procesin e përzgjedhjes për kryeinspektor shëndetësor nuk ka pasur asnjë ndërhyrje politike ose diçka tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Blerand Stavileci. Ministri s'është këtu. A dëshironi të merrni fjalën? Zotit Aliu, fjalën!

LIBURN ALIU: Shumë keq që nuk është ministri. Pak më parë nuk ishte kryeministri, unë po e lë pyetjen për herën tjetër. Pyetja është me rëndësi dhe po shpresojmë se herën tjetër do të vjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues!
Ministër,

Qeveria e kaluar, përkatësisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë pati marrë një vendim për ndarjen e 1 milionë eurove për shkencën. Mirëpo, që nga marrja e atij vendimi e deri më sot, tërë këtë proces e ka karakterizuar një paqartësi e madhe. Pothuaj se askush nuk ka informacione për mënyrën e distribuimit të tyre, madje as ata që punojnë në institucione akademike nuk e dinë se ku kanë përfunduar ato mjete, pasi në fund të fundit është mungesa e rezultateve konkrete në këtë sferë që e shton edhe më shumë këtë paqartësi.

Rrjedhimisht pyetja ime është: Ministër, a janë shpërndarë ato fonde, nëse po, si janë shpërndarë dhe mbi cilat kriteret?

KRYESUESI: Zoti Buja, e keni fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Kasolli,
Faleminderit shumë për pyetjen e bërë!

Për vitin 2010 ishin planifikuar që nga zëri buxhetor - Shërbime dhe mallra, për shkencën të ndahen 1 milion euro. Është e saktë.

Nga këto mjete, me vendimin e Qeverisë së Kosovës për zvogëlimin 5% të kategorisë - Mallra dhe shërbime, ky fond u zvogëlua për 151.000 euro.

Po ashtu, prej tyre 200.000 euro janë destinuar për botimin e kompletit të veprave të akademik Rexhep Qosjes.

Ndërkaq, për shumën tjetër të mjeteve, prej 1 deri më 31 tetor të vitit të kaluar, MASHT pati shpall konkurs publik për këto kategori dhe këto shuma.

Grante speciale për projekte shkencore, kishte paraparë 500.000 euro. Mobilitete afatshkurtra 60.000 euro; Publikime dhe botime të punimeve shkencore 120.000 euro; Projekti i kthimit të trurit 120.000 euro; Shpërblimi shkencëtar i vitit dhe shkencëtar i ri i vitit 45.000 euro.

Parlamenti i Kosovës pati vonuar pak sa themelimin e Këshillit Shkencor, si vend kryesor për menaxhimin e këtyre fondeve, ndërkohë që MASHT-i kishte miratuar një kornizë ligjore dhe kriterë shkencore për përzgjedhjen e punimeve shkencore të aplikantëve që ishin të standardizuara me Bashkimin Evropian.

Meqenëse procedura e vlerësimit të projekteve ishte e gjatë dhe procedurat e prokurimit kërkonin shpenzim të shpejtë të mjeteve brenda vitit fiskal, sepse zëri financiar i mjeteve ishte - Mallra e shërbime e jo - Transfere dhe subvencione, në Këshillin Shkencor të MASHT-it u vendos që vlerësimi i projekteve të shtyhet për vitin 2011.

Këshilli Shkencor i MASHT-it vlerësoi se nga 57 aplikuesit për pikën 1, grante speciale për projekte shkencore, aplikantët kishin aplikuar në projekte të pa kompletuara.

Po ashtu, edhe për pikën 2, Mobilitete afatshkurtra të shkencëtarëve, kishte vetëm 7 konkurrentë ose aplikantë, prej të cilëve kushtet e parapara me ligj i plotësonin vetëm 2, për të cilët u ndanë 3.000 euro.

Ndërsa për pikën 3, Publikime dhe botime të punimeve shkencore, planifikohej të shpenzoheshin 120.000 euro.

Në konkurs aplikuan 35 konkurrentë ose aplikantë, por Komisioni vlerësoi se kushtet për punimet i plotësonin vetëm 13 prej tyre. Shuma e tërësishme që u shpenzua për këtë kategori ishte 43.195 euro.

Ndërkaq, Projekti i kthimit të trurit, nuk kishte asnjë aplikant, kurse pika 5, Shpërblimi shkencëtar i vitit dhe shkencëtar i ri i vitit mbeti pa u realizuar, për shkak se u vlerësua që konkursi kishte konflikt interesi. Pra, mjetet e destinuara për shkencë për Këshillin Kombëtar të Shkencës janë paguar 139 mijë e ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe gjysmë minute, Ramës!

MINISTRI RAMË BUJA: ...543.000 euro nga Fondi i Shkencës, për fat të keq, shkuan në suficit, për shkak të kriterëve që ishin vendosur në konkurs, kriterë këto që ishin harmonizuar me standarde evropiane dhe aplikantët nuk i kishin plotësuar këto kushte. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti deputet? Deputetit Kasolli, fjalën!

AFRIM KASOLLI: Paqartësia që ekziston rreth kësaj të davaritet dhe këtu u pa qartë se kjo Qeveri vetëm kot po e mban, sidomos Ministria e Arsimit vetëm kot po e mban atë slogan që janë për një shtet të dijes, sepse shihet se këta më tepër janë për shtet të asfaltit se sa për dije.

Por unë e kam një pyetje tjetër shtesë. Po ashtu në prill të vitit 2007, Senati... rektorati përkatësisht me një vendim të Senatit pati ndarë 500.000 euro për përkthimin e teksteve bazike universitare prej gjuhëve të huaja. Edhe këtu nuk ka ndodhur asgjë konkrete dhe ne e dimë që për të përkthyer një libër nevojiten gjashtë deri shtatë muaj nëse punohet në mënyrë intensive, po prej 2007 deri sot të mos përkthehet asnjë libër, kjo është absurde.

Pra a keni informata ku janë edhe këto mjete financiare? Faleminderit!

KRYESUESI: Zotit ministër, fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, i nderuar deputet!

Unë për ato mjete që janë ndërlikuar për përkthim në Universitetin e Prishtinës, nuk kam informacion dhe kur ta marr informacionin do tua sjell me siguri, ndërsa për çështjen tjetër se përse është bërë kështu me fondin e shkencës dhe ne jemi Qeveri e asfaltit, nuk jemi qeveri e shkencës dhe dijes, kjo është diçka tjetër sepse, në fakt, ne nuk mund të krijojmë aplikant për të aplikuar për projekte shkencore. Besoj që këtë vit, në bazë të këtyre shenjave që i kemi tash, është më mirë se sa vitin e kaluar dhe besoj se kjo gjë do të realizohet, sepse edhe këtë vit, nëse ju, natyrisht, është fjala për 2012, nëse ju e aprovoni atë fond, që është përsëri njëmilionësh e s'është më shumë, atëherë ne do të jemi falënderues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Imri Ahmeti, pyetje për ministrin Mahir Yagcillar.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Reforma në Administratën publike mbetet një sfidë e mëtutjeshme e institucioneve tona.

Vitin e kaluar, në kuadër të strategjisë së rishikuar për reformën në Administratën publike 2010 – 2013, janë aprovuar dy ligje mjaft të rëndësishme, Ligji për shërbimin civil dhe Ligji për pagat e nëpunësve civilë.

Me Ligjin për pagat e nëpunësve civilë, të aprovuar në maj të vitit të kaluar, është paraparë klasifikimi në paga i shërbyesve civilë përmes sistemit të gradimit me koeficient që përcaktohen sipas nomenklaturës së koeficienteve.

Zoti ministër, pyetja është, kur do të nisë implementimi i këtij ligji për pagat e nëpunësve civilë, përkatësisht a është kompletuar legjislacioni sekondar që rregullon klasifikimin e të gjithë shërbyesve civilë dhe atë do t'i gradojë sipas pozitës duke caktuar nivelin e pagës në sistemin e pagave? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
I nderuari deputet Ahmeti,
Duke falënderuar për pyetje, gjithashtu edhe unë konfirmoj se Ligji për pagat e nëpunësve civilë ka paraparë që për zbatimin e tij të nxirren aktet nënligjore, sidomos ata për klasifikimin e vendeve të punës dhe për shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë.

Në këtë aspekt ju informoj se Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës, pas përfundimit të të gjitha procedurave është dërguar në Qeveri për miratim, më 15 gusht të vitit 2011, mirëpo për zbatimin e klasifikimit janë disa çështje ende të paqarta buxhetore, sepse ka një vlerësim nga ana e Ministrisë së Administratës Publike, një vlerë tjetër, ndërsa e Ministrisë së Financave pak më ndryshe, kështu që nevojiten edhe konsultimet shtesë, sepse është një ligj vërtet i cili do të ndryshojë edhe faktikisht rregulloren e cili do të krijojë zbatimin e ligjit, por do të krijojë edhe një qasje krejt tjetër në shërbimin civil.

Ndërsa Projektregullorja për shtesa në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë, pas përfundimit të procedurave të parapara është dërguar në Ministrinë e Financave, më 14 shtator, për vlerësimin financiar, kështu që me vlerësimin financiar presim që së shpejti do të procedohet në Qeveri. Me aprovimin e këtyre dy rregulloreve, vërtet do të krijohet mundësi për zbatimin e Ligjit për pagat e nëpunësve civilë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zotit Ahmeti, fjalën!

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti ministër!

Se ka një laramani të madhe, divergjenca, diskrepanca në kuptimin e nivelit të pagesave të shërbyesve civilë, jemi të vetëdijshëm të gjithë dhe ky ligj ka pretenduar të rregullojë këtë sferë.

Megjithatë, është me rëndësi të dimë për shërbyesit civilë dhe për qytetarët, a do të fillojë implementimi i këtij ligji në vitin e ardhshëm buxhetor? Meqenëse jemi në fazën përfundimtare të kornizës buxhetore, përkatësisht të qarkores së tretë buxhetore, Ministria juaj sipas ligjit, aktualisht të nenit numër 23, ka për obligim t'i referojë Ministrisë së Financave për masën e mjeteve që janë të nevojshme për të implementuar këtë ligj.

E rëndësishme është t'u thuhet shërbyesve civilë që ligji do të fillojë të implementohet apo nuk do të implementohet.

Aktualisht, përmes shtesave të memorandumit të mirëkuptimit, formave të ndryshme të donacioneve, pastaj edhe në forma tjera të kompensimeve ka divergjenca aq të mëdha, sa që një shofer ndodh e merr pagën mujore më të madhe se një drejtor i departamentit. Këtë e dini, edhe sistemin e ... gjithkush mund ta shohë dhe ta verifikojë. Ka drejtor departamenti që përmes donacioneve dhe formave të ndryshme merr rrogën mbi 2.000 euro, po ka drejtor që e merr vetëm atë që është rrogë bazë.

Do të thotë, këtu ka një divergjencë jashtëzakonisht të madhe, dikujt po i konvenon mos të zbatohet ky ligj, prandaj ju lutem të jeni konkret, do të zbatohet apo jo prej vitit të ardhshëm? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILLAR: Faleminderit! Vërtet ekziston ajo divergjencë e madhe, por unë shpjegova që ne tash si Ministri e Administratës Publike këto dy rregullore, të cilat krijojnë bazën për implementimin e ligjit janë në Qeveri. Nevojiten konsultime. Edhe unë do të isha shumë i kënaqur të zbatojmë prej vitit të ardhshëm, por janë disa çështje dhe pengesa buxhetore të cilat do t'i bëjmë bashkërisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kanë qenë të planifikuara edhe dy pyetje të bëra nga Donika Kadaj, për kryeministrin, njëra, dhe njëra për ministren Mimoza Kusari-Lila. Asnjëri dhe as tjetri s'janë këtu. Atëherë, i shtyjmë për seancën e ardhshme.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datën 6 dhe 7 tetor 2011

Të nderuar kolegë, pyes nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka!

Konstatohet se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 6 dhe 7 tetor 2011.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Komisioni funksional për Legjislacion e ka rishqyrtuar Projektligjin për ndihmë juridike falas dhe Kuvendit i ka rekomanduar që Projektligji t'i kthehet propozuesit, domethënë Qeverisë.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Sa për sqarim, ky ligj po vjen për herë të tretë, është leximi i tretë i tij, jo i dyti. Në leximin e dytë, ne si Komision patëm dhënë përkrahjen që Ligji të votohet, mirëpo me ndërhyrjen e Komisionit për Financa, ligji u rrëzua me arsyetimin se nuk ka buxhet dhe mungesa e paraparë e buxhet nuk mund ta lejojë që ky ligj të vazhdojë.

Problemi lind se ky ligj në leximin e dytë nuk është dashur të rrëzohet, por është dashur të rrëzohet në leximin e parë, sepse amandamentet nuk kanë pasur asnjë implikim financiar. Ligji si i tillë ka implikime financiare, por jo amendamente që janë propozuar nga komisioni funksional. Dhe, normalisht ishte dashur të rrëzohet kur është diskutuar në parim dhe të thuhet që ky ligj nuk ka..., deklarata financiare nuk e përkrah, thotë që nuk duhet të aprovohet dhe ky ligj nuk është dashur të aprovohet. Mirëpo, me insistimin e kryetares së Komisionit për Financa, ky ligj është rrëzuar kështu që neve nuk ka mbetet zgjidhje tjetër vetëm t'ia kthejmë sponsorizuesit dhe të gjejë arsyen ose të gjejë burimet financiare dhe pastaj ta kthejë në komision.

Këtu duhet të kemi parasysh edhe një element tjetër, se ky ligj ka qenë ligj me prioritet i cili është paraparë..., është dashur të aprovohet për Raportin e Progresit, tashmë Raporti i Progresit ka dalë, nuk ka më prioritet në kuptimin e aprovimit të tij për të arritur një instrument ndërkombëtar, duhet të bëjmë një ligj të mirë, duhet të gjejmë edhe burime financiare, kështu që Komisioni ka marrë vendim që ky ligj t'i kthehet sponsorizuesit dhe të gjejë burimet financiare që të jetë i zbatueshëm sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYESUESI: Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, respektivisht nënkryetarin, zotin Osmani, që para deputetëve të paraqet qëndrimin e komisionit.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi pasur një vendim të Parlamentit të nënshkruar nga kryetari Jakup Krasniqi, që sipas kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa që të dy komisionet, Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa të takohen për ta trajtuar këtë çështje dhe për të gjetur zgjidhje.

E vërteta është që kemi qenë neglizhentë dhe ne nuk jemi takuar. Prandaj, unë kisha lutur kryetarin dhe Komisionin për Legjislacion që javën e ardhshme të takohemi së bashku

me ministrin e Financave për të shikuar mundësinë e tejkalimit të kësaj dhe unë propozoj në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa që kjo çështje mos t'i kthehet, ky draft mos t'i kthehet Qeverisë, por të shtyhet për një trajtim të mëvonshëm.

Unë shpresoj që së bashku me ministrin e Financave do të bëjmë zgjidhje për implikimet buxhetore, respektivisht për numrin e të punësuarve diku që sillet rreth 30, që parasheh ligji dhe që krijon implikime.

Ky është propozim i komisionit dhe kërkojmë e lypim konsideratë që javën e ardhshme të takohemi dy komisionet bashkë me ministrin, për të gjetur zgjidhje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Qeveria a dëshiron ta thotë fjalën e saj?

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

E dëgjova me vëmendje edhe vendimin e Komisionit për Legjislacion, po edhe mendimin e nënkryetarit për Komision për Financa.

Ajo çka mund të them, është që Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Drejtësisë, si sponzorizuese e këtij ligji, ka tentuar që të vë kontakte me komisionet përkatëse. Nuk kemi mund që të vëmë kontaktin, nga se do ta pajtonim mendimin paraprak të komisionit, që do të ishte që të mos vijë deri në rend dite dhe të mendohet ndryshe.

Ajo çka mund të them, është që sot mendoj se nuk është mirë të shqyrtohet ky projektligj. Është mirë ndoshta edhe propozimi i zotit Osmani, që e tha, dhe në këtë drejtim do ta jepja mendimin apo qëndrimin edhe timin, si ministër i Drejtësisë, por edhe timin në emër të Qeverisë për çështjet financiare.

Mos të harrojmë se është një prej ligjeve që do të kushtojë, ngase ka të bëjë me ndihmën juridike falas, në veçanti për personat të cilët nuk kanë mundësi materiale ta bëjnë një gjë të tillë.

Unë mendoj Komisioni për Legjislacion të vetmen ankesë e ka çështjen e financave, nuk e ka përmbajtjen e ligjit. Dhe, meqë është në pyetje çështja e financave, atëherë mendoj se duhet ta diskutojmë.

Unë jam i gatshëm që jo për një javë, por për dy javë, ose në mbledhjen tjetër kurdo që mendon Kryesia, ta vëmë prapë, por në ndërkohë të koordinohemi të gjithë bashkërisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Gashi e ka kërkuar fjalën edhe një herë.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Sa i përket Komisionit për Legjislacion, për hir të vërtetës, nuk e kemi pasur as këtë shqetësim çështjen e financave, sepse ne kemi thënë që ky ligj të aprovohet dhe sa po të

garantohen financat, ky ligj të hyjë në fuqi dhe të implementohet sa më mirë që është e mundshme.

Mirëpo, Komisioni për Buxhet e ka ndaluar në seancë. Ne kemi thënë të votohet, Komisioni për Buxhet ka thënë të mos votohet dhe e kanë rrëzuar, kështu që këtu është problemi. Ne si komision nuk kemi qenë kundër dhe mendimi i komisionit ka qenë – ne s’kemi çka të bëjmë për financa, si komision, ne s’mundemi... Ne mund të takohemi sa të duam me Komisionin për Buxhet, por ne nuk mund të marrim asnjë vendim për çështje buxhetore. Ose me Ministrinë, me këndo mund të takohemi, por ne për çështje buxhetore vendim s’mund të marrim.

Meqë teknikisht ne i kemi thënë seancës, ligji është në rregull. Çështjet financiare, Komisioni për Buxhet dhe Financa po e rrëzon, atëherë edhe ne duhet të tërhiqemi dhe t’ia kthejmë sponzorizuesit. Kjo ka qenë procedura. Nëse ka një ide që mund të gjendet një zgjidhje për këtë kohë, besoj se po e marr përsipër që edhe në emër të komisionit të flas, në këtë rast, pa u konsultuar me ta, nëse ka mundësi që të gjendet një zgjidhje financiare brenda dy javëve, në rregull, le të tërhiqet për dy javë.

Ne nuk jemi që të kthehet me çdo kusht ligji në Qeveri. E rëndësishme është që ligji të jetë funksional dhe të vijë edhe buxheti tashmë, meqë e rrëzoi Komisioni për Buxhet dhe Financa, praktika do të ishte që të kthehet në Qeveri.

KRYESUESI: Faleminderit! Për shkak të korrektësisë, unë dua ta lexoj vendimin e Parlamentit, që është:

Shtyhet shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas.

Ngarkohet Komisioni funksional për Legjislacion dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që në konsultim me propozuesin, Qeverinë e Republikës së Kosovës, t’i harmonizojnë qëndrimet lidhur me implikimet buxhetore të Projektligjit për ndihmën juridike falas dhe Kuvendit t’i paraqesin raport me rekomandime.

Do të thotë, obligimet mbi bazën e këtij vendimi nuk janë kryer, të komisioneve bashkë me përfaqësuesin e Qeverisë, andaj po propozoj që Kuvendi të votojë, por mendoj që duhet t’i japë 15 ditë afat shtesë, të paktën, që të gjendet një marrëveshje e mundshme se a ka buxhet a s’ka buxhet.

Po, të merret një vendim shtesë që të shtyhet për 15 ditë, me qëllim që komisionet dhe Qeveria të merren vesh për këtë.

Ju lus që me një votim formal ta miratojmë propozimin. Janë 65 deputetë në sallë.

“Për”? Faleminderit!

“Kundër”, a ka? Nuk ka.

Me vendim unanim u shty dhe vendimi u përsërit, që brenda 15 ditësh të gjendet zgjidhja për pikën e katërt, do të thotë për Shqyrtimin e projektligjit për ndihmë juridike falas. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës, që është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përfitimin e ish - zyrtarëve të lartë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përfitimin e ish - zyrtarëve të lartë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij sipas propozimit të Qeverisë.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për përfitimin e zyrtarëve të lartë dhe i rekomandon seancës që ta aprovojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e komisioneve tjera, kanë të drejtën e fjalës? Nuk ka të paraqitur. Grupet parlamentare? Nuk e donë fjalën. Deputetja Albulena Haxhiu e ka kërkuar fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Unë vetëm desha ta bëj një sqarim në lidhje me këtë pikë. Sa i përket ligjit, pra e kam fjalën për Ligjin për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë, ne si Grup Parlamentar konsiderojmë që disa nene në këtë ligj, sidomos neni 3.1, ku flitet për pagën mujore prej 70% që e marrin ish zyrtarët e lartë pas mandatit, e që i bie afër 1.500 euro, është në shpërputhje me standardin jetësor dhe gjendjen ekonomike sociale në vend, kur i kemi parasysh se sa janë pensionet e që janë të mjerueshme.

Pra, përqindja duhet të jetë më përtokë. Mirëpo, këto nene që për ne si Grup Parlamentar janë problem, nuk kanë qenë për ndryshim, andaj edhe në këtë fazë nuk kemi mund të bëjmë amendamente, pasi që nuk lejohet me rregullore, kështu që për Projektligjin në fjalë do të abstenojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti, Hamiti e ka kërkuar fjalën!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e kam lexuar këtë Projektligj edhe herën e parë, edhe tash kam pritur që do të ketë sqarime, po me amendamente po çuditim, domethënë s'ka ndodhur kurrëgjë, është leximi i parë dhe këtu s'është koha që të bëjmë amendamente.

Ndryshimi themelor prej ligjit ekzistues ka qenë kush janë ish zyrtarët e lartë, kanë qenë 2, janë shtuar edhe 3, kaq, kurrëgjë tjetër nuk ka.

Për mua është këtu me rëndësi që të thuhet, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në "Gazetën zyrtare" të Republikës së Kosovës. E tash, a vlen për kohën e kaluar, sepse ju e dini shumë mirë që ne i kemi pikërisht në Kuvendin e Kosovës rastet e ex - kryetarëve të

Kuvendit, të cilat nuk janë zgjidhur. Çfarë dua të them unë? Me këtë formën, si e ka tash ky ligj, a i parasheh të gjithë kryetarët e Kuvendit të Kosovës? Kjo është pyetja ime.

Kjo duhet të saktësohet këtu, qoftë me një dispozitë ose të thuhet pak a shumë në një mënyrë qysh po them unë, sepse do të kemi edhe një herë mosmarrëveshje qysh është një mosmarrëveshje e pa zgjidhur ligjërish për këtë problem. Këtë e kisha unë. Tjetër punë është që unë mendoj që kjo zgjidhje mund të plotësohet ose zvogëlohet, por kjo është shumë vonë sot sepse i gjithë Kuvendi dhe komisionet nuk kanë rekomandime. Po kjo që po them unë, është domosdo, se ne kemi një kontest të kërkesave të ex-kryetarëve të Kuvendit që nuk janë zgjidhur në bazë të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani zëvendëskryeministri Kuçi ka kërkuar sqarim shtesë.

ZËVENDËSKRYETARI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Profesor Hamiti e ngriti një çështje që ka nevojë për interpretim. Në Projektligj është menduar që të gjithë ish zyrtarët e lartë që kanë mbajtur detyrën mbi 6 muaj t'i kenë privilegjet dhe që nuk kanë burime tjera nga buxheti i Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Sqarimi është i zëvendëskryeministrit. Atëherë, meqë Komisioni ka rekomanduar që Projektligji të miratohet pa ndryshime, votojmë tekstin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përfitimin e ish - zyrtarëve të lartë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani!

Në sallë janë 64 deputetë.

Atëherë, konstatoj se me 45 vota “për”, 11 abstenime, 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 3 L-001 për përfitimin e ish-zyrtarëve të lartë.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, që është:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional, respektivisht nënkryetarin nëse dëshiron fjalën, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk e dëshiron fjalën.

Të drejtë kanë përfaqësuesit e partive politike, respektivisht të grupeve parlamentare. Nuk është paraqitur askush.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e projektamendamenteve. Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 13 amendamente.

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa i ka propozuar 12 amendamente, ndërsa amendamenti numër 5 është propozuar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e komisionit funksional.

KRYESUESI: Pra, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në Raportin e komisionit funksional.

Amendamenti 1

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 2

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 3 “ kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 4

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 5, duhet të votohet me elektronikë.
Zoti Naser Osmani e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Për sqarim, zoti kryesues!

Fjala është për një amendament të cilin Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka mundur ta aprovojë edhe që është një amendament kështu i arsyeshem, por Ligji mbi menaxhimin e financave publike nuk lejon të krijohen fonde të tjera, por e njeh vetëm një fond , atë Buxhetin e Kosovës.

Prandaj, ne nuk kemi mund ta përkrahim edhe lus deputetët që ta votojnë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A përgatitemi për ta votuar amendamentin me elektronikë? Në sallë janë 70 deputetë. Votojmë amendamentin e 5, po e përsëris, propozim i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e komisionit funksional.
Votojmë tani!

Faleminderit! Nuk miratohet. Janë 34 vota “kundër”, 5 abstenime, 15 vota janë “për”.

Amendamenti 6

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 9 votojmë me elektronikë. Votojmë tani.

A e do fjalën? Mirë!

Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, desha të flas për 3 amendamente këtu, për të cilat lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë “kundër”. Është amendamenti 9, 10 dhe 13. Arsyet janë, domethënë, lidhen me tekstin e ligjit në origjinal, por, edhe në anën tjetër është një vërejtje që e kemi për komisionin funksional, i cili në arsyetimin që e ka pru për heqjen apo ndryshimin e këtyre amendamente, nuk ka dhënë arsye, po ka dhënë vetëm shpjegime.

Pra, në pikën 6 të Rekomandimit të komisionit, thuhet që “ arsyetimi për çdo amendament” pastaj shkon duke i listuar arsyetimet.

Te amendamenti i 9, ta zëmë thuhet: “ neni 14 është fshirë duke u vlerësuar i panevojshëm për projektligj” Pra, nuk është arsyetuar pse është i panevojshëm ky, a mbulohet në një ligj tjetër apo ku është çështja? Pra, nuk na ka informuar neve si deputetë, ku është racionalja e fshirjes të këtij neni. Po ashtu edhe te amendamenti 10, thuhet: “neni 16 është riformuluar, ku është hequr dispozita që në banderolë për cigaret të vendoset çmimi i shitjes me pakicë” ky nuk është arsyetim, ky është shpjegim.

Këtu na ka shpjeguar, se çka nënkupton amendamenti, gjë që e kemi edhe në listën e amendamenteve që e kanë sjell në ligj, por nuk arsyetohet pse është hequr çmimi i shitjes në pakicë në banderolat për cigare dhe e njëjta gjë është pastaj te amendamenti 13, te paragrafi 3, faktikisht, i cili hiqet për mundësinë e dënimit personit që është pronar i objektit.

Edhe këtu mendojmë që duhet të ketë gjoba, natyrisht për ata që nuk e respektojnë ligjin edhe mënyrën se si shitet cigarja dhe kujt i shiten. Pra, në këto 3 amendament lëvizja “Vetëvendosje” do të votojë “kundër” për shkak se konsideron që ashtu siç është paraparë me ligj ato duhet të qëndrojnë në këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Salihe Mustafa e ka kërkuar fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Unë e pash të rrugës ta arsyetoj, pse është fshirë neni 14, sepse qysh edhe në leximin e parë unë kam dhënë vërejtjet se neni 14 i Projektligjit për akcizën për duhanin bie ndesh me Ligjin për duhanin, ku aty thuhet që “mund të shitet në aparatet shitëse, ku mund të blejnë edhe fëmija, ndërsa te Ligji për duhanin ndalohet dhe unë jam ajo që pak me vonesë e kam dërguar amendamentin në Komisionin funksional, mirëpo e falënderoj Komisionin që e kanë pasur parasysh. Arsyeja është kjo, dua t’ju sqaroj kolegëve, sepse nuk lejohet, në njërin ligj thuhet: “lejohet të shitet në aparatet automatike duhani” ndërsa në këtë ligj lejohet dhe i falënderoj që e kanë parë të rrugës, sepse ligji do të jetë më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që ne duhet ta kemi parasysh se Bashkimi Evropian gjatë këtij 10 vjeçari do të nxjerr një ligj, i cili cigaren do ta shesë në barnatore, jo në kiosqe dhe jo nga fëmijët, siç po ndodh në Kosovë dhe do të kenë të drejtë ta marrin me recetë të mjekut, cigaren.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Zoti kryesues, është e kuptueshme që Komisioni gjatë shqyrtimit të amendamenteve bën diskutime, debate të ndryshme dhe ato mbasin të shënuara në procesverbal, por asnjëherë nuk jepet arsyetimi për çdo amendament çka ka ndodhur edhe pse ka ndodhur, jepet në përgjithësi kur kryetari i Komisionit e bën sqarimin e tekstit në tërësi.

Janë diskutuar gjerë e gjatë, domethënë edhe përfundimi ka qenë ky që është para jush. Disa çështje i rregullon një ligj tjetër, është Ligji për duhanin. Ne këtu kemi të bëjmë vetëm për akcizën në duhan, domethënë për një taksë që nuk rregullohet kjo çka po kërkohet nga disa deputetë, për arsye se këtë çështje e rregullon, siç e tha deputetja, ligji tjetër. Prandaj, unë mbetem edhe njëherë që të votohen rekomandimet e komisionit funksional.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për përkujtim, edhe njëherë po ju përkujtoj që deputetët kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e të gjitha komisioneve, pa marrë parasysh a janë deputetë apo s’janë, kur kanë interesa të veçanta që të trajtojnë ose kanë diçka të paqartë, ose donë të thonë fjalën e tyre dhe kanë të drejtë diskutimi. Në votim s’kanë të drejtë. Faleminderit!

Votojmë amendamentin 9 me elektronikë. Votojmë tani.

Në sallë janë 75 deputetë.

Konstatohet se me 50 vota “për”, 12 vota “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti i 9.

Amendamenti 10, votojmë me elektronikë, prapë. Votojmë tani.

Konstatohet se me 52 vota “për”, 10 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti 12

“ Kundër” s’ka, abstenim s’ka.
Miratohet.

Amendamenti i 13, me elektronikë. Votojmë tani!
Faleminderit! Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Konstatohet se me 61 vota “për”, 3 abstenime, asnjë votë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për akcizën në produktet e duhanit.

Pika e 7 e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Forenzikës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj anëtarin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetin Fatmir Xhelili që para deputetëve të arsyetojë Raportin me rekomandime.

Zoti Fatmir Xhelili, e keni fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni ynë ka shqyrtuar me vëmendje projektligjin në fjalë dhe bashkë me rekomandimet që ka dhënë unanimisht, i propozon Kuvendit që të miratojë këtë projektligj, në mënyrë që t’i mundësohet Agjencionit të Kosovës për Forenzikë që të kryejë punën e vet dhe t’i krijojë relacionet, obligimet dhe përgjegjësitë e tij në kuadër të ligjit e jo në bazë të akteve normative që ka qenë gjer tani, pasi që ka qenë agjencion në kuadër të policisë. Andaj, unanimisht komisioni propozon që ky ligj të miratohet me amendamentet në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Salih Morina e ka kërkuar fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të thotë, në parim çështja e ligjit nuk ka të bëjë me ndonjë vërejtje në hartimin e tij, domethënë, në përpilimin e neneve dhe nën - neneve, por, është një çështje që lidhet pikërisht edhe me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndihmë juridike. Kur të shikohet deklarata financiare, do të thotë, ky ligj është i kushtueshëm, ky ligj është i papërbalueshëm për buxhetin e Qeverisë së Kosovës. Ky projektligj kërkon një staf shtesë prej 29 vetash dhe po ta shikojmë edhe në vërejtjen, do të thotë, zoti kryesues që është dhënë edhe në Raportin e Progresit se Kuvendi i Kosovës ka disa pengesa, do të thotë sa i përket procedurave të tilla dhe njëra prej tyre është edhe pikërisht çështja e buxhetit, të cilat ligje po vijnë nga Qeveria me deklaratën financiare e cila kërkon që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë.

Për shkak se buxheti, do të thotë, nuk ekziston as për vitin e parë, nuk ekziston as për vitet në vijim dhe kjo ka të bëjë pikërisht me Rregulloren e Parlamentit dhe kryesisht me nenin 54 të Rregullores së Parlamentit ku thotë që: “çdo ligj i cili inicohet nga sponzorizuesi, nga Ministria përkatëse aprovohet në Qeveri dhe vjen në Parlament, duhet ta ketë buxhetin fillestar për vitin e parë, pastaj edhe në vitet në vijim”.

Prandaj, do të ishte mirë edhe si Kryesi e Parlamentit, edhe ju si kryesues që ndoshta të lëshoni edhe një shkresë zyrtare për komisionet në Parlament, po ashtu keni të drejtën të lëshoni edhe udhëzime administrative që ligjet e tilla, të cilat aprovohen në Qeveri dhe nuk kanë buxhet, mos të vijnë në Parlament, ose të definojnë qartë në Deklaratën financiare se ky ligj nuk ka buxhet për vitin e parë apo pas kornizës afatmesme e cila është e aprovuar si strategji e Qeverisë së Kosovës.

Prandaj, në parim do të thotë, edhe në hartimin e dytë unë nuk e kundërshtoj ligjin, por duke marrë për bazë se Departamenti i Buxhetit, në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, ka deklaruar se ky ligj nuk mund të votohet për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore, do të ishte mirë që edhe ky ligj t'i kthehet edhe njëherë Komisionit për Buxhet, që ta shqyrtojë edhe njëherë, t'i marrë ato krahasime dhe ta shohë mundësinë se çka mund të bëhet në planifikimin e buxhetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Fatmir Xhelili e ka kërkuar fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni ka shqyrtuar edhe çështjen të cilën e diskutoi deputeti Morina, mirëpo konstatimi qëndron se Agjencioni funksionin tash e sa vite dhe ka vijën e vetë buxhetore që e ka pasur në kuadër të policisë, por ajo vë buxhetore do të ndahet edhe do të jetë eksplicite për Agjencionin.

Faktikisht, Agjencioni ka nevojë për kuadro plotësuese dhe për kuadro shtesë, mirëpo në hap e sipër ato kuadro do të shkojnë në edukimin dhe trajnime të ndryshme që mundëson Qeveria buxhetore për Agjencionin të plotësohet vit pas viti, varësisht prej nevojave për kuadro të Agjencion, andaj me vetë faktin që Agjencioni funksionon dhe ekziston vija buxhetore për Agjencionin, nuk kemi asnjë arsye për të mos e votuar projektligjin në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne e kemi edhe rekomandimin e Komisionit, i cili thotë që nuk ka implikime shtesë buxhetore, prandaj po vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti i 2

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti i 3, me elektronikë. A është në pajtim? Okej!

Atëherë, amendamenti 3

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 6

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 7

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 8

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 9

“Kundër” s’ka, abstenim s’ka.

Miratohet.

Tani votojmë tekstin në tërësi me amendamentet e miratuara. Konstatohet që në sallë janë 78 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Konstatohet që me 56 vota “për”, 6 abstenime, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Kemi edhe 3 pika të rendit të ditës. A doni t’i përfundojmë krejt, meqenëse kemi edhe një votim të fshehtë, apo doni pauzë dhe pastaj të vazhdojmë? Okej.

Pika 8 e rendit të ditës:

**8. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Republikës
së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit
të Pavarur për Miniera dhe Minerale**

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Propozim- vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Kuvendit i ka rekomanduar për emërimin e njërit nga dy të propozuarit për anëtar në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, në qoftë se dëshiron ta marrë fjalën lidhur me këtë. Nuk dëshiron.

Kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti, nuk është. Kryetarët ose përfaqësues të grupeve parlamentare nuk janë paraqitur.

Është paraqitur deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i fton deputetët e Kuvendit të Kosovës që kësaj radhe të vendosin në parim me ligjet dhe konform ligjeve, sepse dy emrat e sjellë në Parlamentin e Republikës së Kosovës janë dy emra të cilët janë militantë të Partisë Demokratike të Kosovës, njëri është asamblist, do të thotë, në njërin nga komunitetet e Kosovës dhe emri i cili është eliminuar në Qeveri është profesor, doktor, njeriu i cili ka një përvojë jashtëzakonisht të madhe, apatiak dhe apolitik, ndërkaq nuk është sjellë e as nuk i është dhënë mundësia që të paktën ky Kuvend dhe këta deputetë të vendosin se kush duhet të jetë në këtë agjencion, i cili po quhet “i pavarur” e të cilin kjo Qeveri po do ta bënë “të varur” ashtu qysh i keni bërë të varur edhe të gjitha agjencionet tjera. Pra, mbasandaj nuk mund të presim që do të vijin raporte progresi, por janë raporte regresi, në fakt, të cilave po ua sheh sherrin krejt vendi, e krejt zhvillimi dhe e gjithçka për shkak

të tendencës kaq të madhe që çdo pore të jetës kjo Qeveri ta manipulojë, ta monopolizojë dhe të ketë militantë të vet.

Unë po ju lus dhe po ftoj, të nderuar kolegë deputetë, që t'i thërrasim mendjes dhe t'i kthejnë këta dy emra dhe të kërkojmë që një komision që është profesionist të bëjë përzgjedhjen konform kriterëve që parashihen me ligj dhe mos të jetë gjithmonë kriter që dikush të jetë anëtar i një partie politike dhe nuk ka rëndësi a ka kriterë tjera profesionale dhe të zgjidhet dhe të marrë një pagë apo çka do tjetër, të marrë vendime që çdoherë shkojnë, do të thotë, në kundërshtim me interesat e shtetit dhe në interes të partisë e cila e ka vu në atë agjencion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër Hajredin Kuqi e ka kërkuar fjalën.

HAJREDIN KUQI: Nuk e pata ndërmend, se nuk është pikë që duhet ta diskutojmë, por e pash Donikën shumë entuziaste edhe thashë t'ia jap një përgjigje.

Është jo logjike, nëse ju thoni që njerëzit që i përkasin një partie, janë kundër shtetit, të partisë tjetër, janë për shtetin ose ata që s'kanë parti. Ana tjetër është që nëse doni të bëni një krahasim me ardhjen tonë në Qeveri, ne i kemi hequr ministrat prej bordeve, ju i keni pasur ministrat në borde dhe kryetarë të bordeve.

Dhe, ana e tretë është me ligj, Qeveria ka të drejtë që t'i propozojë. Unë nuk hy në kualifikimet dhe perceptimet e tyre partiake, por ajo çka dua të them është - kanë kaluar procedurat me konkurs, procedurat ligjore, ka ardhur emri. Është në dorën e Kuvendit le të vendosë, por në kuptimin e asaj se dikush është kundër shtetit, dikush për shtetin, dikush e bën këtë edhe ata që janë në komision, edhe pse e kanë emrin të pavarur, e kanë një ligj që duhet të vendosen në bazë të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Donika Kadaj- Bujupi ka kërkuar replikë.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: I nderuar zëvendëskryeministër,

Është për keqardhje që gjithmonë pikë referuese po e keni një qeveri, e cila mandatin e vet e ka kryer në vitin 2007. Unë po flas për sot, po flas atë se çka po bëni në 3 vjetët e fundit, atë se çka po ju thotë bota dhe është shumë e saktë që nëse keni anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës, ne do të luftojmë deri edhe në Gjykatën Kushtetuese që këta njerëz të mos jenë në Komisionin e Pavarur për Miniera, sepse kështu po e prishni shtetin dhe bëhet fjalë për njerëz militantë që janë joprofesionistë.

Unë nuk po dua të hy a janë patriotë a s'janë, se nuk ka qenë aty kriter patriotizmi ose përkatësia politike, por po hy në atë që nuk janë profesionistë, nën 1, dhe nën 2, është me ligj e ndaluar që dikush që është militant, ka post politik, të jetë anëtar i një komisioni të pavarur, është me ligj. Dhe ju si ministër i Drejtësisë, është për keqardhje të thoni që nuk është me ligj e shkruar që mund të jesh edhe anëtar, edhe asamblist i një partie politike e ndërkohë që mund të mbash post në Komisionin e pavarur. Atëherë, po ia ngjesim emrin "Komisioni i varur" e jo i pavarur, ju lutem, veç kjo me të vërtetë po më

bën nervoz. Keni të drejtë, nuk është punë entuziazmi, por po më bën nervoz, se nuk mundet të jetë me ligj e paraparë që një agjencion i pavarur të ketë profesionistë, ndërkohë që Qeveria eliminon emrat që janë profesionistë, sepse nuk e kanë kriterin e përkatësisë politike ose nuk e kanë të shkruar PDK. Ju lutem, është absurde!

KRYESUESI: Zoti Kuqi, kundër replikë.

HAJREDIN KUÇI: Unë nuk e di kush janë ata profesionistë, të ma japësh emrin, të tregoj edhe cilës parti i takon. Shumica e personave i takojnë diku me letra apo pa letra. Besoj që këtë e di unë më mirë se sa ju, por një punë duhet ta them, në logjikën politike ai që fiton zgjedhjet, ajo parti që i fiton zgjedhjet, nuk i dënon anëtarët e vet dhe nuk është mëkat të jetë anëtar i një partie, aq më pak i PDK-së.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, me fuqinë që kam si deputet, kam qejf t'i lexoj të gjitha letrat që na i servon për këtë dhe i kam lexuar edhe këto dy letra. Këtu shihet që Komisioni i ka pyetur ose marrë, vlerësuar dhe i ka qar 5 emra në Qeveri, domethënë duhet ta kenë të qartë edhe deputetët, por edhe këta të komisioneve të Kuvendit.

Po ju them të gjithëve me radhë që janë bërë përtacë shumë të mëdhenj dhe nuk janë duke u referuar si duhet, se e kanë detyrë ta thonë këtë. Në Qeveri s'kanë shkruar 2 emra, kanë shkruar 5. Qeveria i paska zgjedhur këta dy që na i rekomandon ne t'i votojmë. Tash, puna e përkatësive politike, ky është problem i madh te ne, problem është a është funksionar dhe a është militant dhe a i pëlqen një parti, rreqi të hajë, ne këtu nuk do të mund ta zgjidhim kurrësi, por nëse është në funksione, atëherë ajo është e identifikuar dhe duhet të thuhet, deri këtu.

Meqë këta 2 emra na kanë ardhur, unë jam përpjekur t'i shoh biografite dhe begraundin e tyre, por edhe këta s'janë njësoj, nëse të dytë janë të PDK-së, atëherë ka bërë gabim PDK-ja që e ka qitur të parin me rend atë që e ka qitur, pse? Sepse, ai është bachelor, ky tjetri është inxhinier, bile është master.

Pra, unë jam prej atyre që mendoj që edhe në përfaqësimet politike dhe jo politike, Kosovës i duhen ekspertët dhe është gabim kardinal që të rangohet i pari ai që është më i dobët, kjo është logjikë e keqe. Unë nuk i njoh personalisht, por biografite po thonë kështu dhe ai është këtu edhe një non sens. I dyti, ky që ka shkollë më të madhe, domethënë përgatitje edhe të zanatit, se është inxhinier dhe kemi të bëjmë me një Komision për Miniera dhe Minerale, tash ky me gjasë është këtu në punë, domethënë, ky është anëtar, sepse ne kemi një letër që na qohet, ku thuhet, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ku thuhet, filan fisteku, konkurrenti thotë: "e ka kontratën aktuale deri në datën 31.5.2014" atëherë, pse zgjidhet ky tash, ky e paska? Këtu është një hallakamë, një moskuptim që kurrkush s'i bie në fije, një njeri që e ka, bile thotë, kontrata e tij thotë se kontrata e tij vazhdon më 31.5.2014, me mundësi vazhdimi edhe përtej

këtij. Çka po bëjmë ne sot këtu? Po ky qenka! Këtu dikush duhet ta sqaroj, ose Qeveria që është propozues, ose komisioni dhe t'u thotë deputetëve, nuk është mirë të bëjmë votime të fshehta me sy mbyllur pa e ditur problemin. S'ka qysh votohet njeri, nëse e ka mandatin, pse? Për ta hequr, atëherë unë jam totalisht kundër, të PDK- së e të LDK- së e të gjithëve, nëse njeri është në mandat. Pse? Nëse s'është, atëherë thoni që kjo letër që është dëshmi e institucionit, ky njeri punon, është letër e keqe. Qe ku e keni, ju lutem, këtu e keni, lexojeni. Për njërin prej tyre, unë emra s' përmenda me qëllim, po, po, që është i rekomanduar, nëse është i rekomanduar, domethënë.

Këtu është një konfuzion total. Ju lutem, sqaroni Qeveria ose Komisioni përgjegjës. Kaq.

KRYESUESI: Deputetja Berisha- Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përsëritet, zoti zëvendëskryeministër!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Hamiti, a ka mundësi të dëgjoni sqarimin? Profesor, deputet Hamiti, a bën ta bëj një sqarim në dilemën që e ngrite së fundi rreth kandidatëve?

Unë, së pari kërkoj nga kjo seancë që ta plotësojmë një vakum institucional, ta plotësojmë bordin e KPMM-së me një anëtar, Qeveria i ka sjellë 2 emra. Ju jeni të lirë të votoni për cilin emër të doni, por është mirë ta analizoni mirë dokumentacionin i cili na ka ardhur për këta dy kandidatë dhe ne kemi në fuqi një Ligj për miniera dhe minerale, neni 59 i këtij ligji e definojnë shumë mirë, e përcakton se kush i plotëson kushtet të jetë anëtarë i Bordit të KPMM-së. Dhe unë nuk do të hyj të analizoj se cili kandidat i plotëson kushtet, por po dua të bëj një sqarim rreth dilemës që e ngriti zoti Hamiti.

Vërtet, kandidati, njëri prej kandidatëve është pjesë e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe unë duhet t'ua sqaroj juve se ai institucion, të cilin e ka themeluar Kuvendi, i ka më shumë se 70 të punësuar, mirëpo kandidati në fjalë është zyrtar i thjeshtë dhe ligji nuk ia ndalon të konkurrojë që të jetë anëtar i bordit të KPMM-së dhe duke qenë si zyrtar, e ka kontratën, aq sa po thoni, deri në vitin 2014, prandaj unë ju ftoj të votoni atë që i plotëson kriteret ligjore.

Të dy janë, sigurisht Qeveria e ka bërë përcaktimin dhe përzgjedhjen dhe janë njerëz të cilët e meritojnë të jenë në bord, por ne për fat të keq duhet ta votojmë vetëm njërin dhe jo të dytë, prandaj cili i plotëson kriteret ligjore, ju kisha ftuar ta respektoni ligjin, të cilin e kemi në fuqi. Dua të jap edhe një përgjigje tjetër, një deputeti tjetër që e ngriti, njëri prej kandidatëve vërtet i plotëson kriteret ligjore të parapara me nenin 59 të Ligjit për miniera dhe minerale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën, për replikë.

SABRI HAMITI: Jo, jo, unë veç e falënderoj, faleminderit që e dha arsyetimin, se kjo është dashur të thuhet në fillim, por edhe njëherë le ta lexojë letrën. Letra që e kemi ne, nuk kallëzon çfarë statusi ka ai, kjo po tash po thotë që është zyrtar i thjeshtë. Shumë mirë që qenka, por është dashur të shkruhet. Mënyra qysh është shkruar letra, s'e përcakton funksionin e tij. Prandaj, duhet në këso raste kur sillen letrat që mund të interpretohen në 500 mënyra, të precizohet - ky njeri punon në këtë komision, po e ka këtë funksion dhe i bie shqip, po do të bëhet më madh. Kjo është normale, por nuk është thënë në mënyrën qysh e keni letrën, le ta studiojnë, nuk e thotë këtë dhe unë, domethënë, mora përgjigje, por është dashur të merret në fillim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Ardian Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar! Mendoj se një pjesë e shpjegimit u dha në diskutimin e parafundit, mirëpo as që e pata në plan të flas për këtë temë, se qëndrimin e grupit e dha deputetja Kadaj-Bujupi pak më herët.

Ajo që po dua të them, është se zëvendëskryeministri krejt kohën na foli për kandidatët hipotetikë, sikur të kish qenë ose sikur të mos kish qenë e nuk na tha asnjë fjalë për këta kandidatë që janë dhe e tha një fjalë që partia në pushtet i shpërblen anëtarët e vet. Krejt në rregull, hajt se po ia pranojmë, mirëpo nuk bën t'i shpërbleni në këtë mënyrë kaq brutale duke i shkatërruar institucionet e pavarura të shtetit, të cilat janë ndërtuar me shumë mund.

Nuk po flasim për simpatizantë të partive, ne po flasim për njerëzit që mbajnë poste partiake, kjo është esenca e punës. U tha më përpara, ne nuk mund ta dimë cili individ, cilën parti e simpatizon edhe nuk po duam ta dimë, nuk po na intereson, po ligjet tona dhe kultura shtet-formuese edhe fryma jonë që e kemi ndërtuar kushtetuese këtu, na thotë që njerëzit të cilët mbajnë poste partiake, poste të rëndësishme, mund të them, tani për tani nuk duhet të jenë në këto komisione të pavarura.

U përmendën edhe bordet, bordet janë diçka tjetër. Unë kisha dashur që edhe këta t'i kenë ministrat në borde, në mënyrë që të marrin përgjegjësinë e plotë për keq menaxhimin nëpër këto borde, por çka kanë bërë tash, e kanë shti një buffer, i kanë vendosur disa njerëz që kështu ashtu ju përgjigjen këtyre edhe i kanë hequr duart prej zjarrit dhe prapëseprapë e menaxhojnë, nëse kjo është ajo për çka foli. Edhe njëherë po ju them, në komisionet e pavarura të futen njerëz, të cilët mbajnë pozita politike partiake, është shkatërrim i jetës institucionale në Kosovë, nëse donë të kuptojnë mirë, nëse nuk donë, po më vjen keq, shumë keq, po më vjen keq edhe për Kosovën, mirëpo shpresoj që nuk do të jetë tepër vonë derisa njerëzit ta kuptojnë që kjo është saktë mënyra për ta shkatërruar atë ndjenjën e ndërtimit të shtetit, nëse kurrëgjë tjetër. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Urdhëro! Hajredin Kuqi e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë dola për zotin Gjini që t'i jap, mbasi më parafrazoi fjalimin, do të thosha, kështu.

Shiko, zoti Gjini, për pozitat e larta partiake, unë pajtohem plotësisht se ligji s'e lejon, edhe nëse duam edhe unë, edhe ti, por unë nuk e di këta kandidatët, s'jam gardian i asnjërit për ta mbrojtur, por nuk e di që kanë një pozitë të lartë partiake, përmendjani emrat, thoni e mban këtë pozitë dhe me automatizëm ai dihet. Në anën tjetër, mos e harroni edhe një fakt, që njerëzit kur zgjidhen në pozita të caktuara, kanë mundësi të zgjedhin, a e marrin pozitën paraprake e mbajnë, apo hyjnë në pozitën tjetër dhe nuk mund ta nënshkruajnë kontratën për punë apo ta marrin vendimin para se ta bëjnë një zgjedhje të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Ardian!

ARDIAN GJINI: Unë mendoj që po duhet t'i vizatojmë sendet. Unë mendoj që është tepër politik një person i cili e përfaqëson një parti politike në asamblenë komunale, është zgjedhur me flamur partiak, cilëso parti që i takon ai, në këtë rast është PDK.

Qysh mund të mos jetë politik, kur është i zgjedhur politik i asaj partie? Unë, veç t'i vizatoj këto sende dhe, fundi i fundit, është demagogji të japë dorëheqje mbasandaj. Mos kështu, të jemi pak të saktë! Nëse një njeri është zgjedhur me vota duke e përfaqësuar një subjekt politik, dhënia e dorëheqjes mbasi ta marrë postin në institucion të pavarur, është me të vërtetë farsë. Ikni prej këtyre sendeve, t'i mbyllim më njëherë e përgjithmonë. S'po na ka hije hiq!

KRYETARI: I kemi edhe tre emra këtu. Pra, e keni kërkuar fjalën të flisni tash? Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMDANI: Faleminderit, kryetar!

Është në të njëjtën logjikë edhe ajo që e tha zoti zëvendëskryeministër, të njëjtën logjikë me pranimin e realitetit të asaj që ka thënë Komisioni Evropian në Raportin e Progresit. Edhe kjo që u tha që janë anëtarë të PDK-së, prandaj ne duam t'i shpërblejmë si anëtarë tonë, shumë shkurt po e them, është logjika e "kapsamunit" e kapsamun në këtë logjikë të qeverisjes së këtuhit, domethënë, të kapësh sa të mundesh", edhe këta të tjerët, këqyri karriget që janë zbrazët të Qeverisë, kanë shkuar të kapin ndonjë gjë.

Kjo duhet të ndalet, logjika "e kapsamunave" duhet të ndalet edhe është shumë keq që madje tash edhe publikisht po thuhet që, po, e kemi këtë mundësi ta kapim këtë element, këtë pozitë, duam ta kapim. Faleminderit!

KRYETARI: Florin Krasniqi e ka fjalën.

FLORIN KRASNIQI: Fakti se PDK-ja i ka shndërruar këto borde në vend punësimi për militantë, të gjithë po e dimë edhe s'po mund ta ndalim këtë të keqe, po çka tha zëvendëskryeministri se Kosova nuk ka intelektualë, e profesionalë, apolitikë, mendoj që është fyese për këtë Kuvend, është fyese për ata që janë profesionalë e intelektualë, janë

apolitikë, janë kombëtarë. Mendoj që Kosova ka shumë intelektualë edhe profesionalë që ne i degradojmë për çdo ditë si shtet, tash edhe kryeministri si zëvendëskryeministër, të lutem Hajredin, nuk është në nivelin tënd intelektual të thuash një gjë të tillë, se unë mendoj dhe të gjithë deputetët e dinë se ka shumë njerëz që janë apolitikë, e shumë të ngritur dhe të gatshëm që të punojnë për këtë vend. Ua jepni mundësinë se nuk keni për t'u penduar. Faleminderit!

KRYETARI: Hajredin Kuçi, replikë.

HAJREDIN KUÇI: Florin, ose nuk e kam thënë unë mirë, ose ti s'e ke dëgjuar mirë. Dhe unë po të jap sqarimin tash. Merre transkriptin, kam thënë shumica që po i përmend, përndryshe për rastin konkret, që përmendi Donika, dhe unë e di cili rast është, ka qenë anëtar i Kryesisë së AAK-së në Klinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Florin Krasniqi, replikë.

FLORIN KRASNIQI: Mos ta shndërrojmë këtë Kuvend edhe këtë shtet në lojë të ulët politike. Ju lutem, ua jepni mundësinë, vetëm mundësinë njerëzve që kanë bërë shumë për këtë vend. Mos i ulni këto nivele të bordeve, mos i ulni se janë tepër të rëndësishme për shtetin, janë tepër të rëndësishme për të ardhmen tonë. E unë e di se njerëzit kanë nevojë, militantë kanë nevojë, edhe të partisë suaj, edhe të partive tjera për punë, por mos e ulni nivelin, për të ardhmen e këtij vendi, mos, se jeni kah bëni gabim, të gjitha bordet i keni politizuar, është shumë keq. Tepër keq. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra, deputetë,
Mendoj që është përcjellë një procedurë e cila deri sa ka ardhur në selektimin e dy emrave, që rrjedh edhe nga Komisioni për Zhvillim, Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti e Industri, ku janë pjesëmarrës të gjitha partitë politike dhe ky debat i ka takuar atje në komision, jo në Kuvend, që të humbet kohë dhe mendoj që 2 emrat, të cilët janë selektuar këtu, është me orientim të qartë selektues edhe nga Qeveria, edhe në komision dhe nuk ka nevojë të jepen epitete politike ose të tjera, por që të vazhdohet me një vlerësim real për ta.

Ky bord është shumë i rëndësishëm për minierat, kur dihet që minierat dhe mineralet në Kosovë janë duke u keqtrajtuar dhe ne na nevojitet t'i plotësojmë kapacitete sa më shpejt, që të kemi edhe rezultate më të mira. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Nuk kemi të lajmëruar më për diskutim. Megjithatë, unë duhet t'i them dy fjalë për raportimet e komisioneve.

Unë mendoj që në rastet e tilla, pasi është çështje e Kuvendit dhe Kuvendi e merr përgjegjësinë për votimin ose jo, Komisioni është i obliguar të tregojë pak më mirë edhe zhvillimin e procedurave, së paku zhvillimin e proceduarve në Kuvend dhe në cilin rast respektohet ligji edhe në cilin rast nuk respektohet ligji. Ne jemi të obliguar që në këto raste ta shikojmë respektimin e ligjit dhe komisioni do të duhej të njoftonte se cili kandidat me ligj i plotëson kushtet, në mënyrë që ne mos ta shkelim ligjin duke eliminuar një kandidat që i plotëson kushtet dhe duke zgjedhur një kandidat që nuk i plotëson kushtet. Nëse ne e bëjmë një veprim të tillë, ta dimë që ne po e shkelim ligjin dhe ne si deputetë s'kemi të drejtë ta shkelim ligjin se, në fund të fundit, Qeveria ka të drejtë ta propozojë 1,2,3 dhe 4 kandidatë edhe pa i plotësuar kushtet, por ne duhet të jemi ata që e bëjnë përzgjedhjen e kandidatit që i plotëson kushtet. Ky është obligimi ynë.

Meqenëse unë si kryetar i Kuvendit mund të them që Kuvendi po merr shpeshherë përgjegjësi, që në fakt nuk janë të tij dhe ndoshta edhe me ligj janë përcaktuar keq, se Kuvendi po e merr përgjegjësinë kur të tjerët po e bëjnë përzgjedhjen. Dhe do të duhej kjo praktikë të ndryshojë.

Ne do të duhej ta marrim përgjegjësinë, por ta marrim përgjegjësinë komplet mbi bazën e ligjeve që janë në fuqi. Megjithatë, sipas nenit 59, paragrafi 5 i Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, Kuvendi e emëron njërin nga kandidatët në pozitën përkatëse ose i refuzon të gjithë kandidatët për pozitën përkatëse.

Nëse Kuvendi i refuzon të gjithë kandidatët për pozitën përkatëse, Qeveria menjëherë e riinicion procesin e përzgjedhjes dhe dërgon në Kuvend emrat, të paktën të 2 kandidatëve të rinj, në kualifikim. Kështu thuhet në ligj, por nëse një kandidat që e kemi përpara, përkatësisht njëri i plotëson kushtet për t'u zgjedhur dhe tjetri jo, unë mendoj që është në obligimin e Kuvendit të bëjë përzgjedhjen për kandidatin që i plotëson kushtet.

Unë po ftoj që kryetarët ose grupet parlamentare t'i përcaktojnë anëtarët për Komisionin Zgjedhor.

Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Është mocion i drejtpërdrejt, kërkoj që të hidhet në votim propozimi jonë që është për kthimin e 2 kandidatëve edhe njëherë që të mos votohen fare sot, që Qeveria të përzgjedhë kandidatë tjerë. Kërkoj që Kuvendi të deklarohet për propozimin tonë, që të mos votohen sot këta kandidatë. Faleminderit!

KRYETARI: Unë të falënderoj shumë për këtë që po propozon ti dhe nuk kam kurrgjë diçka kundër, por unë jam i bindur se Qeveria përsëri e bën përzgjedhjen dhe nuk do të kemi diçka të tillë. Unë mendoj që bordi i Komisionit për Miniera dhe Minerale është mirë të plotësohet, nëse një kandidat veç i plotëson kushtet që të jetë aty.

Fjalën e ka kryetari i komisionit, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht, unë nuk e pash shumë të nevojshme si komision, sepse mu duk që sot ka mbetur vetëm ana formale edhe pata arsye të madhe, sepse në komision asnjëra nga këto çështje që u shtruan këtu, nuk janë shtruar nga përfaqësuesit e partive politike që janë anëtarë të komisioneve, që është dashur t'i ngritin këto çështje në komision.

Më lejoni t'ju sqaroj vetëm edhe disa çështje të cilat edhe këtu u ngritën. E para, për sa i përket vendimit, procesi i seleksionimit ashtu-kështu do të vijë deri te njëri. Në komision të vetmen gjë që nuk e kemi pasur të qartë, është që do të duhej të votonim atje brenda komisionit për ta reduktuar në një apo jo dhe kemi marrë sqarime nga administrata e Kuvendit, pas kërkesës sonë, që vetëm të bëjmë aprovimin, gjegjësisht të shikojmë a janë në përputhje me ligjin.

Pasi kemi konsideruar si komision që CV-të ose propozimet e sjella prej Qeverisë janë plotësisht në përputhje me ligjin, kemi dhënë dritën e gjelbër që këto të vijnë në Kuvend. Më lejoni, pasi e mora fjalën, vetëm se i mbeta borxh që i vetmi debat ndoshta që ia ka vlejtur të qitet këtu në seancë, ka qenë i një deputetes, zonjës Kostiq, që ka të bëjë me përfaqësimin e pakicës serbe, e për çka po ashtu kemi thënë që komisionet tjera duhet t'i trajtojnë, eventalisht kjo puna e përfaqësimit duhet të mund të ishte edhe ndonjë procedurë tjetër, në qoftë se është e nevojshme edhe të ndërrohet ligji.

Çështje tjera këtu nuk janë ngritur në komision dhe unë besoj që tash është koha kur duhet të vazhdojmë me votimin për anëtarin. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet Gjini, mocioni është dashur të jetë në fillim dhe ai nuk është bërë, por mocioni mund të bëhet në seancë për këto çështje: për ta shtyrë debatin, për ta shtyrë mbledhjen, për ta bartur një çështje në komisione, për përfundimin e debatit, për të konstatuar nëse është shkelur Rregullorja, për të konstatuar nëse janë shkelur të drejtat e deputetëve.

Tani kemi hyrë veç, i kemi debatuar...

(Ndërhyrje)

Por, edhe nëse shtohet, ajo duhet të jetë në fillim të seancës. Po ftoj që grupet parlamentare ta caktojnë nga një anëtar për komision.

Në emër të Partisë Demokratike, një emër.
Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozojmë Blerta Kodrën, që të jetë në komision.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

(Deputetët e LDK-së dhe të lëvizjes “Vetëvendosje” e braktisin seancën)

KRYETARI: Në mungesë të kuorumit, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër ose nëse në mbledhjen tjetër votohet që t'ia kthejmë Qeverisë, por e vërteta është se kanë mundur të jenë kandidatët më serioz...

Mirupafshim në seancën tjetër!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës